

Zgjedhjet e parakohshme mund të shtyjne Regjistrimin

Fq.5



VRASJET E FUNDIT Qytetarët ndjehen të pasigurt

Fq.6



Ardian Nuhiu merr timonin e Shkupit?

Fq.19



Koha

www.koha.mk



Lufta për kontrollin e Golanit

Fq.16

AKTUALE

Kemi grurin tonë, por hamë bukë serbe



Prej 11 deri 11.5 denarë për një kilogram është çmimi blerës i grurit, por sasi të kryesisht eksportohen në Greqi dhe Shqipëri, thonë prodhuesit. Ndërkohë, përpunuesit importojnë miell serb sepse, sipas tyre, logjika e tregut është - çmimi më i mirë për cilësi më të mirë. Siç tha dje kryetari i Odës së agro-biznesit pranë Lidhjes së Odave Ekonomike (LOE)...

Fq.5

GLOBI

Zvicra kërkon punëtorë duke i pajisur me leje

Fq.15

RAJON

Ja hapat që Ballkani Perëndimor duhet t'i ndërmer

Fq.14



PUSHTETI DHE OPOZITA LARG KONSENSUSIT POLITIK

ZGJEDHJET E PASHMANGSHME



Analistë politik dhe profesor të së drejtës kushtuese janë të një mendimi se opsioni më i mundshëm është mbajtje zgjedhjeve të parakohshme bazuar në qëndrimin e fortë të VMRO-së kundër ndryshimit të emrit të shtetit. Ndërkohë, Mickovski ka kërkuar dorëheqjen e parevokueshme të Prokurorit të përgjithshëm dhe zgjedhjen e një Prokurori të ri me propozim të opozitës, zgjedhjen e Qeverisë së re teknike me pjesëmarrjen edhe të VMRO-së në bazë të Marrëveshjes së Përzhinos

Fq.3

Asnjë plan për ndotjen e ajrit

Shkup, 2 tetor - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinorë duket se nuk ka një plan konkret si ta pengojë dhe ndalojë ndotjen e ajrit që, kryesisht gjatë vjeshtës dhe stinës së dimrit, rrit grimcat e dëmshme toksike PM10. Ankesat drejtuar kësaj ministrie vijnë kryesisht nga organizatat joqeveritare që merren me ndotjen e ajrit, ndërkohë që shpërfillen dhe mediat, të cilët duhet të presin me muaj

për të marrë përgjigje rreth kësaj problematike. Madje, edhe pyetjet e mediave, ashtu sikurse të gazetës KOHA, nuk marrin përgjigje lidhur me paralajmërimet se po përgatitet Strategji për mbrojtje nga ndotja e ajrit. Aktivistëve ekologjik dhe organizata joqeveritare vlerësojnë se deri më tani duhej të merreshin masa konkrete lidhur me ndotjen e ajrit, pasi siç thonë ata, si gjithmonë...

Fq.9



EDITORIAL

NDASITË MAQEDONASE DHE AXHAMILLËQET SHQIPTARE



Emin AZEMI

Ndasitë brendamaqedonase dhe mosndërtimi i një qasje principiale e shqiptarëve kundrejt kësaj ndasie, është thelbi i krizës aktuale në Maqedoni. Lidhja Social Demokrate bashkë me kryeministrin gabimisht e paskan lexuar situatën në terrenin e tyre social e etnik. Gjithë ato para të derdhura për hulumtimin e opinionit publik, si nuk paskan mundur të detektojnë disponimin e fshatarëve maqedonas, të cilët përgatitjen e ajvarit kanë mundur ta shtyjnë për ndonjë ditë tjetër, e jo bash të dielën kur u mbajt referendumi. Propaganda opozitare, përfshi edhe paradat e fasules, u tregua më efikase se parullat e zbrazëta të pushtetit dhe kundërshtarët e referendumit mbetën ushtarë besnik të kauzës së mosndryshimit të emrit të shtetit.

Tani VMRO ka arsye të ndjehet më e faktorizuar në këtë situatë turbulente. Në fakt, atë e faktorizoi politika eklektike e Zaevit dhe për rrjedhojë Maqedonia sërish u kthye në vorbullën e përplasjeve pushtet-pozitë, me kauza të vjetra që po shiten si taktika të reja.

Hendeku brendamaqedonas, në thelb ka një mospajtim, por në tërësinë e çështjes del që mospajtimi të jetë i degëzuar, ku shqiptarët, gjithsesi, qëndrojnë varur diku me pafuqinë e tyre për të imponuar vetveten si faktor. Pafuqia esenciale e shqiptarëve nuk lidhet gjithaq me kulturën e pamjaftueshme qytetare për të tejkaluar bindjet partizane, sa qëndron në mosgatishmërinë e krijimit të opsioneve me fundament politik e kombëtar, që do të merreshin për bazë në çfarë do lloj negociimi me palën maqedonase. Tash së fundmi, madje po dëgjojmë edhe për lista të përbashkëta, ku votat e shqiptarëve mund t'i ekspozohen edhe një rreziku me pasoja të asimilimit edhe më të theksuar politik të tyre. Sikur shqiptarët të ishin angazhuar më tepër për opzione që do të koncentronin fuqinë politike të tyre, situatën do ta kishim krejt ndryshe. As që do ti shkonte ndërmend dikujt për lista të përbashkët, dhe më së paku do të kujtohej të rekrutojë banditë shqiptarë, për të luajtur rolin e pykave e kallauzëve, si instrumente që e bën më të sofistikuar ndërhyrjen brutale në trupin elektoral të shqiptarëve.

Maqedonia edhe kështu siç është nuk ka nevojë për ndonjë ndërhyrje nga jashtë, për të qenë e paaftë në rrugëtimin e saj euro-atlantik. Me mosndryshimin e emrit, bojkotuesit e emrit deshën të na tregojnë se ky rrugëtim mund edhe të shtyhet për "ditë më të mira", atëherë kur Brukseli do të lodhet me thirrjet e veta, që ngandonjëherë dalin të jenë tepër të flashkëta. Burokracia i BE-së e mori me sportivitet piknikët parareferendumiane të Zaevit dhe u tregua naive kur mendoi se në këtë pjesë të Ballkanit mangupët e vegjël të politikës e paskan kaluar me sukses kursin e pjekurisë eurointegruese.

Asnjë kurs nuk përvetësohet plotësisht nëse paraprakisht nuk kalon testin e provës. Maqedonisë i duhet edhe një semestër leksionesh që të dijë të ndajë patriotizmin rural maqedonas nga aspiratat e pastër europiane. Shqiptarët mund edhe të mos e ndjekin këtë semestër, por kjo nuk nënkupton neglizhimin e faktorëve që i bën ata më të konsoliduar politikisht.

PA REGJISTRIM, S'KA ZGJEDHJE

"Pa regjistrimin e popullatës, në Maqedoni çdo votim, çdo zgjedhje e zakonshme apo jashtëzakonshme është thjesht tallje me qytetarët! Mediat botërore nuk e njohin mirë situatën aktuale në Maqedoni, prandaj mund të dalin me teza të ndryshme rreth votimit për referendum dhe rreth asaj se kush humbi e kush fitoi!! Ata për shembull nuk e dinë se në Maqedoni nuk është zhvilluar procesi i regjistrimit të popullatës ka afër 20 vjet! Nuk e dinë për shembull se në Maqedoni votojnë edhe të vdekurit që ka mbi 300 mijë vota fiktivë! Subjektet politike shqiptare i dinë këto fakte, dhe me kokëfortësi, ose për shkaqe shërbimi për të marrë një kolltuk, marrin pjesë në zgjedhje, marrin pjesë ja si puna e referendumit etj! Regjistrimi në 2020 është shumë larg, këtë regjistrim të largët personalisht nuk e shoh të arsyeshëm!", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga diaspora, Alisetar Ramadani.



T'IA LEXOSH MENDJEN POPULLIT

"Shumë i gjetur skenari i mbrëmshëm... kapiteni di t'ja lexojë mendjen popullit të telenovelave dhe që vdes të përgjojë nga vrima e çelësit jetën personale të komshiut.

Uroj ta kenë shijuar dhe këto gratë e shoqërisë civile që dinë dhe anglisht...

Tani bëni atë që dini të bëni më mirë, ankohuni, shani dhe mallkoni fatin që ju ka lënë mbi kokë Edi Ramën. Rrini të qetë se nëse do t'ju vijë radha, do e ketë gati një skenar me dhunë, seks dhe dashuri të pamundur edhe për ju!", shkruan në profilin e saj në Facebook, gazetarja nga Tirana, Desada Metaj.



25 VITE DEMOKRACI

"Ne 25 vite demokraci, shumë njerëz kanë bërë karrierë politike dhe ekzekutive pro aderimit të vendit në NATO. Madje mbi këtë narativ edhe janë fituar zgjedhjet. Nga të dyja kampet etnike. Një lloj siç ka patur edhe të tilla që kanë bërë karrierë politike kundër NATO-s. Fakt është se pas 25 viteve pavarësi ato që ishin KUNDER fituan, e këta që janë PRO rrjedhimisht mendoj se këta të dytët duhet të marrin përgjegjësi...", shkruan në Facebook, eksperti i ekonomisë, Visar Ademi.



ME QENË SI MERKELI

"Me qenë unë si Merkel, Macroni, Kurzi..., që nesër në mëngjes, do ua vendosja vizat qytetarëve të Maqedonisë. Jo vetëm vizat, por urgjentisht do iu vendosja sanksione ekonomike deri sa të ngordhim urie. Pjesa dërrmuese e popullatës (shqiptarë, maqedonas...) edhe ashtu ka gjene lindore...", shkruan në FB, aktivisti nga Kumanova, dr.Selver Jashari



MEDIACitate

SIPAS BEOGRADIT, QENKAN MBI 200 MIJË SERBË TË ZHVENDOSUR NGA KOSOVA

Në territorin e Serbisë (qendrore, siç e quan Beogradi) janë 201.077 persona të zhvendosur nga Kosova, ose 15 mijë sish më shumë se në vitin 2.000. Këto janë të dhëna në Raportin e Komisaritit për refugjatë e migracione të Serbisë, me titull "Gjendja dhe nevojat për personat e zhvendosur inter", bën të ditur agjencia serbe e lajmeve FoNet. Po sipas këtij burimi, nga këta 76 për qind janë serbë, afër 15 për qind romë, 2,79 për qind malazezë, 1.96 boshnjakë dhe 1.54 për qind goranë.

Raporti thekson se personat e zhvendosur intern kanë pasur në Kosovë 12 mijë shtëpi, mbi 3 mijë apartamente, rreth 6 mijë parcela të tokës bujqësore dhe mbi 400 njësi hapësirash banesore. Po sipas këtij burimi, 20 për qind e pasurive të tyre janë të uzurpuara, ndërsa 13 për qind janë me pronësi të kontestueshme. Theksohet se rreth 4 për qind e pronave janë shitur, ndërsa vetëm 0,21 për qind janë shkëmbyer. Raporti shton se 56 për qind e pronave të personave të zhvendosur intern është shkatërruar, ndërsa 11 për qind e tyre aq është dëmtuar se është e pabanueshme. Vetëm 5 për qind e personave të zhvendosur intern të evidentuar në Serbi janë kthyer në Kosovë, ndërsa mendojnë të kthehen vetëm 1.165 persona. Beogradi shpesh jep shifra për numrin e serbëve në Kosovë, në veri e jug të Ibrit, që shkojnë deri në rreth 200 mijë sish. Sipas kësaj matematike serbe në Kosovë do të duhej të ishin mbi 400 mijë serbë. Të kujtojmë se sipas regjistrimit të organizuar e të kryer nga Beogradi në Kosovë në vitin 1991 ka pasur 194.190 serbë. E pra serbët gjithmonë kanë pasur natalitet të ulët dhe del absurd shifra prej mbi 200 mijë serbëve të zhvendosur nga Kosova në Serbi.

(FoNet, 2 tetor)


NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE KRISTAQ SOTIRI?

Kristaq Sotiri (1883-1970) ishte fotograf, mjeshër i portretit dhe i peizazhit. Lindi në Mborje.

Në Korçë kreu shkollën fillore dhe më pas punoi në një studio, ku fitoi njohuritë e para të fotografisë. U end si i mërguar ekonomik për disa vite në Amerikë, derisa gjeti vend në studion e mjeshtrit Xh. Stekel, në Los Anxhelos. Më pas hapi një studio në Nju

Jork. Në vitet 1922-1923 u kthye në Korçë dhe hapi një studio ku punoi vetëm me dritë të natyrës. Janë të njohura portretet "Lipësi mandolinist", "Gajdexhiu" etj. K. Sotiri mori pjesë në një ekspozitë të artizanatit shqiptar në Tiranë më 1931 dhe në Bari të Italisë ku fitoi medalje. Arkivi me vlerë i tij numëron mbi 15.000 negativa në xham dhe në film.



ATHINA ZYRTARE
NUK HEQ DORË NGA
MARRËVESHJA E
PRESPËS



Koxiasit s'i bëhet vonë për censusin e referendumit

Athinë, 2 tetor - Referendumi nuk është as kusht, e as kërkesë juridike për implementimin e Marrëveshjes së Prespës, por është zgjedhje e Shkupit, tha shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias në intervistën për televizionin shtetëror grek ERT, duke komentuar dhe shpjeguar rezultatin nga referendumi në Maqedoni. Koxias theksoi se Ivanovi për president dhe Zaev për kryeministër janë zgjedhur me numër më të vogël të votave që i fitoi "PRO" në referendumin.

"Marrëveshja thotë se (referendumi) është zgjedhje e Qeverisë së Shkupit, por nuk është as kusht, as parakusht, as kërkesë juridike për implementim të marrëveshjes, kjo është me rëndësi të madhe. Tani shkojmë në pjesën politike. Përqindje e madhe është 37-38 për qind? Në shikim të parë kur dikush e shikon, nëse nuk i di politikën ballkanike dhe politikën e Shkupit dhe realitetin e tyre, do të thotë se është e vogël. Edhe është logjike. Por, nëse di se sa vota janë këto 37-38 për qind dhe se çka ndodhi në zgjedhjet paraprake, atëherë do t'i kuptojë disa gjëra", tha Koxias, duke përmendur se sa vota kanë fituar kryeministri Zoran Zaev në zgjedhjet në vitin 2016 dhe presidenti Gjorge Ivanov në zgjedhjet e fundit presidenciale. Siç njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina, ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, në intervistën për televizionin shtetëror grek, shpjegoi se nuk janë pastruar Listat zgjedhore dhe se nëse kanë votuar të gjithë që kanë të drejtë vote, sipas trupit real votues nga një deri në 1.2 milionë votues, shumica nga 50 për qind +1 do të jetë nën 600.000, gjegjësisht 540.000-550.000. "Trupi real votues është rreth një milion, 1.100.000 deri në 1,2 milionë. Në këtë trup real 'PRO' Marrëveshjes së Prespës fitoi mbi 50 për qind. Gjegjësisht edhe të votonte i gjithë trupi votues, rezultati sërish do të ishte mbi 50 për qind", tha Koxias.

PUSHTETI DHE OPOZITA LARG KONSENSUSIT POLITIK

ZGJEDHJET E PASHMANGSHME

Analistë politik dhe profesor të së drejtës kushtetuese janë të një mendimi se opsioni më i mundshëm është mbajtje zgjedhjeve të parakohshme bazuar në qëndrimin e fortë të VMRO-së kundër ndryshimit të emrit të shtetit

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 2 tetor - Partia më madhe opozitare - VMRO-DPMNE këtyre ditëve do të gjendet para një sprovë të vështirë, të pranojë të votojë ndryshimet kushtetuese për Marrëveshjes me Greqinë, në të kundërtën do të duhet të përballet shumë shpejtë me zgjedhje të parakohshme. Zyrtarisht, nga VMRO mbajnë qëndrimin se vullneti i qytetarëve i treguar në referendum ishte kundër ndryshimeve kushtetuese. "Tani për tani nuk ka bisedime dhe rezultati i referendumit është i qartë dhe tregon qartë vullnetin e qytetarëve që të mos kenë ndryshime kushtetuese në lidhje me marrëveshjen e nënshkruar me Republikën e Greqisë", ka thënë zëdhënësi i VMRO-së, Dimçe Arsovski.

Sa i përket ndryshimeve kushtetuese, kryetari i VMRO-së deklaroi se asnjë deputet i partisë së tij nuk do të votojë për kërkesën e kryeministrit Zaev dhe madje ka kërkuar që këtë të mos e bëjnë edhe deputetët e tjerë në Parlament. Mickovski ka thënë se VMRO është e gatshme për zgjedhje të parakohshme, por vetëm nëse paraprakisht plotësohen kushtet e saj.

"Ne kërkojmë dorëheqjen e parrevokueshme të Prokurorit të përgjithshëm dhe zgjedhjen e një Prokurori të ri me propozim të opozitës, zgjedhjen e Qeverisë së re teknike me pjesëmarrjen edhe të VMRO-së në bazë të Marrëveshjes së Përzihos, ashtu siç është vendosur edhe me Ligjin e miratuar në Parlament, e cila do të ketë mandat vetëm se për organizimin e zgjedhjeve", ka deklaruar Mickovski. Është çështje ditësh kur kryeministri Zaev do të nisë bisedimet me partitë politike parlamentare për të marrë përkrahje e tyre për votimin e ndryshimeve kushtetuese. Nëse eventualisht nuk ka sukses, pritet që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Për të shpallur zgjedhje të parakohsh-



me, shumica veçmë i ka numrat në Parlament, më shumë se 61 deputetë, dhe nëse ndodh kjo, VMRO duhet të zgjedh të hyj apo jo në zgjedhje. Kjo, pasi Zaevi duket më se i vendosur të çojë vendin në zgjedhje të reja nëse rast se nuk do të arrij konsensus me opozitën. Por opsioni për zgjedhje të reja nuk e ka përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare tani për tani, duke insistuar që Marrëveshja me Greqinë të zbatohet sa më shpejtë nga partitë politike në Parlament. Shumica e zyrtarëve më të lartë të BE u prononcuan në këtë drejtim, ndërsa edhe Departamenti i Shtetit Amerikan, duke përhëndetur votën pro në referendum, përmendën Parlamentin ku duhet të ndodhin ndryshimet kushtetuese. Së fundmi, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se Republika e Maqedonisë mund të bëhet anëtare e Aleancës në vitin 2019 me kushtin që të pranojë Marrëveshjen e Prespës. "Negociatat për praninë të Maqedonisë mund të përfundojnë në janar të vitit të ardhshëm dhe në fillim të vitit 2019 shteti mund të bëhet anëtare e NATO-s", deklaroi Stoltenberg. "Kjo mund të ndodhë vetëm me miratimin e Marrëveshjes së Prespës. Negociatat për anëtarësim filluan dhe presim t'i përfundojmë në janar të vitit të ardhshëm. Kur do të përfundojë pranimi i Marrëveshjes, mund të nënshkruajmë protokoll me IRJM-në. Në fillim të vitit, shteti mund t'i bashkëngjitet Aleancës. U bëj thirrje të gjithëve të tregojnë përgjegjësi dhe ta shfrytëzojnë atë mundësi", tha më tej Stoltenberg.

Mbetet të shihet nëse bashkësia ndërkombëtare do të bëjë presion të fortë ndaj VMRO-së që të pranojë ndryshimet kushtetuese ose të pranojë faktin që në Maqedoni të kemi zgjedhje të reja. Ana-

listi politik Ibrahim Mehmeti thotë se zgjidhja më e mirë për Maqedoninë do të ishte që VMRO të ulet në tavolinën e bisedimeve me Qeverinë dhe t'i përkrah ndryshimet kushtetuese.

"Marrëveshja me Greqinë është obligim për shtetin dhe mosimplementimi nga ana e Maqedonisë padyshim se do të ketë konsekuenca për të gjithë, përfshirë edhe opozitën dhe të gjithë qytetarët. Andaj, çdo opozite konstruktive duhet ta ketë parasysh këtë fakt dhe të sillet me përgjegjësi", thotë Mehmeti. Nëse për çfarëdo arsye opozita refuzon të marrë pjesë në implementimin e marrëveshjes, Mehmeti thotë se Qeverisë nuk i mbeten shumë opsione dhe s'do mend se zgjedhjet e parakohshme mund të jenë të domosdoshme.

"Një hap i këtillë nuk do të ishte në dobi të proceseve aktuale, mirëpo del se një hap i atillë mund të jetë imponim, të cilin Qeveria vështirë se do të mund ta anashkalojë. Unë megjithatë shpresoj se faktori ndërkombëtar do të angazhohet edhe njëherë që të gjendet zgjidhje e cila do ta evitonte shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, mirëpo gjithashtu duhet ta kemi parasysh se edhe durimi i faktorit ndërkombëtar ka kufi dhe mbetet të shpresojmë se Maqedonia megjithatë nuk do të gjendet në situatë të izolimit ndërkombëtar, gjë që do të ishte epilogu më i keq i kësaj drame më të re politike", thotë Ibrahim Mehmeti.

Aleksandër Kërzhallovski, nga Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar thotë se si në çdo zgjedhje tjera edhe kësaj radhe shoqëria është mjaft e polarizuar. Sipas tij, mos arritja e censurit paraqet argument të fuqishëm për VMRO-në, por nga ana tjetër -

mbi 90 për qind e votës pro po ashtu është në favor të LSDM-së. Se si do të shkojë situata më tutje, Kërzhallovski jep tre opsione. "I pari më takimin liderëve Zaev-Mickovski të dakordohet mbështetja e VMRO-së për ndryshime kushtetuese me atë që do të kishite koncesione serioze për kërkesat e kësaj partie e që sipas meje, nuk është shumë e sigurt se do të ndodh. Opsioni i dytë do të ishte të bëhen përpjekje që të binden për të votuar ndryshimet kushtetuese. Kjo nuk është e pamundur nëse kampi 'për' vendosë për një procedurë të tillë dhe do të ketë kohë të ndikohet individualisht tek deputetët dhe eventualisht të arrihet deri te numri i nevojshëm prej 81 deputetëve. Megjithatë, pritja ime është se kjo nuk do të ndodh. Nëse është i tillë vlerësimi edhe në koalicionin qeveritar, opsioni më i pashmangshëm si skenar i tretë - mbeten zgjedhje të parakohshme, gjegjësisht do të shpallehin deri në fund të kësaj jave ose më së voni javën e ardhshme ndërsa do të realizoheshin në fund të nëntorit", thotë Kërzhallovski.

Profesori i së drejtës kushtetuese, Mersim Maksuti, është skeptik se do të arrihet marrëveshja për miratimin e ndryshimeve kushtetuese me VMRO-në për shkak të qëndrimeve të forta të kësaj partie kundër ndryshimit të emrit të shtetit. Por Maksuti nuk e përjashton si mundësi që deputetët nga VMRO-së të votojnë pro. "Nëse nuk arrihet numri i caktuar i votave në Parlament, atëherë me shumë gjasë do të hyjmë në zgjedhje të parakohshme si e vetmja mundësi për tejkalim të krizës dhe mënyrë për implementimin e Marrëveshjes së Prespës", thotë Maksuti, duke besuar se opsioni i dytë është më tepër real që të ndodh në skenën politike të vendit.



VMRO ra në testin e pjekurisë

Bruksel, 2 tetor - Raportuesi për Maqedoninë në Parlamentin Evropian, Ivo Vajgël, për MIA ka deklaruar se VMRO-DPMNE nuk e kaloi testin e pjekurisë në referendumin për Marrëveshjen me Greqinë dhe vlerëson se sjellja e kësaj partie, bashkë me presidentin Gjorge Ivanov, fsheh tentimin të mbrohen ata të cilët kanë shkëlur ligjin. "Ka edhe disa punë që nuk janë transparente, Më duket se VMRO-DPMNE me taktizimin e saj dëshiron të mbrojë njerëzit të cilët kanë shkëlur ligjin, kundër të cilëve ka hetime dhe procedura gjyqësore", ka thënë Vajgël. Ai e rikujton këtë parti se për BE-në ato çështje patjetër të mbeten në duart e gjyqësisë, pasi, "korrupsioni dhe shkelja e ligjeve dhe dhuna në Kuvend nuk mund të lihen anësh". Ai shpreh keqardhje që opozita dhe presidenti Ivanov nuk i vendosin interesat e shtetit para atyre partiake. "Mendoj se VMRO-ja ra në testin e pjekurisë dhe se ai angazhim i VMRO-së dhe i presidentit nuk mund të arsyetohet me disa argumente oportuniste që i dedikohen vetëm raporteve të forcës në politikë, jo të ardhmes së vendit. Kur e krijuam marrëveshjen e Përzihës të gjitha partitë u obliguan të vendosin interesat prapa dhe se do t'i përkushtohen të ardhmes së vendit", ka thënë Vajgël. Sipas tij, kryeministri Zoran Zaev ka legjitimitet të vazhdojë me kërkesën e shumicës për ndryshimet kushtetuese në Kuvend dhe fokusin e vendos në atë të cilët thanë "po", e jo bojkotit.

ASELBORN TREGON RREZIQET NËSE NUK MIRATOHET MARRËVESHJA

"Nëse doni të jeni anëtare e BE-së dhe NATO-s, duhet të jepet diçka. Edhe një herë pranimi i propozimit për emrin nuk është i pabalancuar. Edhe fati i shumë, shumë të rinjve në Maqedoni, i të gjithë popullit të Maqedonisë varet nga kjo. Ose të ngelesh i barrikaduar edhe një dekadë, si që ishte në vitin 2005 ose të bëhet ky hap dhe të shkohet përpara, kjo është gjithë ajo që mund të them", ka thënë Aselborn

Bruksel, 2 tetor - Ministri për Punë të Jashtme i Luksemburgut, Zhan Aselborn, rekomandon se nëse Marrëveshja me Greqinë nuk votohet në Parlament, Maqedoninë e pret edhe një dekadë në vendnumëro si që ishte në vitin 2005. Aselborn, i cili arriti ndërtojë kompromis në qershor kur kolegët e tij nga Franca dhe Holanda kundërshtonin për datën e negociatave për Maqedoninë, bile edhe kushtëzues, thotë se në politikë nuk ka sukses pa ndjenjë për kompromis.

"Në politikë duhet të dihen mirë të vlerësohen punët: që të fitohet diçka, duhet të jepet diçka për këmbim. Nëse doni të jeni anëtare e BE-së dhe NATO-s, duhet të jepet diçka. Edhe një herë pranimi i propozimit për emrin nuk është i pabalancuar. Edhe fati i shumë, shumë të rinjve në Maqedoni, i të gjithë popullit të Maqedonisë varet nga kjo. Ose të ngelesh i barrikaduar edhe një dekadë, si që ishte në vitin 2005 ose të bëhet ky hap dhe të shkohet përpara, kjo është gjithë ajo që mund të them", ka thënë Aselborn. Aselborn, i cili si ministër i shtetit anëtar të BE-së

MAQEDONIA NË VENDNUMËRO EDHE

10 VITE



dhe NATO-s, si edhe shtetet anëtare tjera vendos për pranimin e Maqedonisë në Aleancë dhe negociatat me BE-në, thotë se nuk shih mënyrë pa kompromis me Greqinë që të shkohet tutje në rrugën euroatlantike. Dyert e këtyre dy organizatave do të mbyllën.

"Unë nuk shoh se si do të mund të hapim dyert nëse nuk pranohet marrëveshja. Dyert hapen me marrëveshje. Pa marrëveshje, dyert nuk hapen. Nuk jam fatalist, por mund të zgjas, e dini, mund të zgjas... Prandaj, konsideroj se kjo është përgjegjësi e vendit dhe varet nga votimi në Ku-

vend. Kjo është kjo", ka thënë Aselborn. Shefi i diplomacisë së Luksemburgut nuk mendon se referendumi ka dështuar pasi mbi 90 për qind e qytetarëve thanë "po" për marrëveshjen edhe pse pranon se censusi paraqet problem. Prandaj, thotë ai, çelësi është në duart e deputetëve të Maqedonisë.

"E ardhmja e të rinjve varet nga kjo. Të rinjtë duan të shohin drejt Evropës dhe të jetojnë në vend që një ditë do t'i takojë BE-së. Shikoni, unë nuk i njoh ndjeshmëritë në Parlament, por është kjo përgjegjësi e krejt Kuvendit, jo vetëm e një

partie apo koalicioni dhe nga ajo do të varet e ardhmja e vendit tuaj", rekomandon Aselborn. Sipas tij, mosarritja e censurit nuk do të thotë se të gjithë ata të cilën nuk dolën të votojnë janë kundër Marrëveshjes me Greqinë. "Si edhe në gjitha shtetet evropiane ju jeni demokraci reprezentative parlamentare. Nuk mund të themi se referendumi ka dështuar plotësisht. Ata që nuk votuan, nuk është qind për qind sigurt se kanë qenë kundër. Ndoshta kanë shprehur se edhe pa pjesëmarrjen e tyre do të jetë mjaftueshëm", thekson Aselborn.

DIPLOMACIA AUSTRIAKE KËRKON QË PARLAMENTI TA MBAROJË PUNËN

Shefja e diplomacisë austriake, Karin Knajsel, konsideron se edhe krahas mospjesëmarrjes së referendumi për emrin e Maqedonisë, para së gjithash nga jehona e dobët e votuesve, deklarimi të dielën tregoi "sinjal të qartë për mbështetje" të zgjidhjes së kontestit të emrit me Greqinë. Edhe ministri austriak për çështje evropiane, Gernot Blimel, është i bindur se referendumi do të çojë në zgjidhje. Blimel ka vlerësuar

se bëhet fjalë për shans historik për Maqedoninë dhe tërë rajonin, si dhe për rrugën drejt BE-së. Në deklaratën për mediat austriake, Blimer ka theksuar se Austria qartë mbështet këtë zgjidhje. Edhe pse jehona e qytetarëve ka qenë më e vogël se sa pritej, Karin Knajsel ka porositur se institucioneve tani u mbetet të marrin hapin e ardhshëm që do të çojë në bisedimet paraqasëse me BE-në.

OKB ofron mbështetje për Maqedoninë nëse është e nevojshme



Nju Jork, 2 tetor - Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Antonio Guterres, është njoftuar për rezultatin e referendumi në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, që u mbajt më 30 shtator. Zyra e shtypit nxori të hënën një deklaratë, në të cilën

theksohet fakti, se shumica e votuesve që votuan ia dhanë votën Marrëveshjes së Prespës. Sekretari i Përgjithshëm i bën thirrje të gjitha forcave politike të vendit të procedojnë për zbatimin e saj nëpërmjet institucioneve të vendit. Sekretari i

Përgjithshëm rithekson angazhimin e Kombeve të Bashkuara për të dhënë, nëse është e nevojshme, të gjithë mbështetjen e duhur, si nëpërmjet të dërguarit të posaçëm ashtu edhe me agjencitë, programet dhe fondet e OKB.

Reagon Rusia, mbështetje bojkotit të referendumi

Moskë, 2 tetor - Rezultati nga referendumi në Maqedoni tregon se votuesit vendosën të bojkotojnë zgjidhje të imponuara nga jashtë, njoftoi Ministria ruse e Punëve të Jashtme.

"Politikanët udhëheqës nga NATO dhe Bashkimi Evropian drejtpërdrejtë u inkuadruan në fushatën propaganduese, duke mos u përmbajtur nga përzierja në

punët e brendshme të vendit. Edhe krahas faktit që dy e treta e qytetarëve të Maqedonisë nuk e mbështetën Marrëveshjen e Prespës, rezultatet nga referendumi menjëherë u përhëndetën nga liderët e BE-së dhe NATO-s, si dhe nga Uashingtoni. Ata janë vendosur ta përfshijnë Shkupin në NATO edhe krahas qëndrimit kundërshtues të qytetarëve të Maqedonisë",

njoftojnë nga MPJ-ja e Rusisë. Moskë zyrtare, siç thuhet, edhe më tej e përfaqëson pozicionin parimor se një zgjidhje e përhershme mund të gjendet vetëm midis dy vendeve, pa përzierje nga jashtë, dhe vetë në kuadër të sistemit juridik dhe me mbështetje të gjerë publike.

"Është e qartë se Marrëveshja e Prespës nuk i përmbush këto kritere. Ajo është kontradiktore me të

drejtën ndërkombëtare dhe Kushtetutën e Maqedonisë, që vazhdimisht është theksuar nga presidenti i shtetit Gjorge Ivanov, duke e përfshirë edhe fjalimin e tij Para Asamblesë Parlamentare të KB-së. Rusia si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të KB-së me vëmendje e ndjek situatën. Konsiderojmë se në pajtueshmëri të paragrafit 3 nga Rezoluta 845 e KS të



KB-së, rezultatet nga negociatat midis Shkupit dhe Athinës duhet të shqyrtohen në Këshillin e Sigurimit", thuhet në kumtesën e MPJ-së ruse.

Nëse vendi shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme dhe vullneti politik do të mungojë, gjasat që censusi të zhvillohet në vitin 2020 janë minimale, pohon numri dy i këtij institucioni, zëvendësudrejtori Zirap Ademi

Koha Evis HALILI

Shkup, 2 tetor - Operacioni i numërimit të popullsisë, i parashikuar të zhvillohet në vitin 2020, sërish mund të dështojë. Nëse vendi shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme dhe nëse vullneti politik do të mungojë, gjasat që censusi të zhvillohet në datën e parashikuar janë minimale. Kështu pohon numri dy i këtij institucioni, zëvendësudrejtori Zirap Ademi, sipas të cilit, përgatitjet për zhvillimin e një prej proceseve më të rëndësishme për popullsinë janë në rrjedhë e sipër. Paketa me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për regjistrimin ende nuk ka përfunduar.

"Sa i takon zgjedhjeve, atyre të parakohshme, në rast se zhvillohen tani dhe jo në vitin 2020 kur planifikoheshin dhe në rast se do të mungojë vullneti politik dhe çështja e regjistrimit do të zhvendoset nga prioritetet, atëherë do të kemi vërtet problem me realizimin e këtij procesi në afatin e parashikuar. Nuk është problem data, nëse mund të jetë prilli, apo tetori, por shumë çështje që duhet të zgjidhen në ndërkohë, si më kryesore është Ligji për regjistrimin, i cili duhet të marrë miratimin nga Parlamenti. Nëse faktorët politikë do të jenë në ndërkohë të zënë me

FLET ZËVENDËSDREJTORI I ESHS-SË, ZIRAP ADEMI

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME MUND TË SHTYJNË REGJISTRIMIN



çështje të tjera, atëherë do të kemi ndërlikime. Gjithsesi ne jemi duke u përgatitur për të filluar këtë procedurë. Nga ana tjetër, dua të sqaroj sa i takon ngatërresave që krijohen gjatë mbajtjes së zgjedhjeve, apo referendumit. Listat zgjedhore nuk kanë të bëjnë aspak me regjistrimin e popullsisë, pasi ai nuk mund të shfrytëzohet për azhurnimin e Listës zgjedhore. Numërimi i popullsisë, që në fakt është fotografimi i gjendjes momentale dhe të dhënat e dala prej tij, përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe ne ligjërisht nuk na lejohet që t'ua japim institucioneve të tjera për qëllime administrative, si në këto raste Ministrisë Punëve të Brendshme që merret

vetë me azhurnimin", thotë Ademi. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë datojnë që nga vitin 2002, ndërsa numërimi i nisur në vitin 2011 dështoi. Sipas Ademit, presionin më të madh për realizimin e

këtij procesi - ESHS e ka nga komuniteti i biznesit, por edhe nga institucionet e tjera shtetërore. Me përllogaritjet e deritanishme, ky proces do të kushtojë dyfish më lirë sesa ai i kaluari dhe koha e për-

punimit të të dhënave do të reduktohet ndjeshëm, deri në dy apo tre muaj, nga një vit që zgjaste më parë.

Regjistrimi do të bëhet sipas metodës së kombinuar, grumbullimi i të dhënave nga terreni dhe nga gjashtë regjistrat administrative, ndërsa numri i operuesve në terren me disa përjashtime nuk do të jetë më shumë se një person. Po ashtu, do të regjistrohen të gjithë ato persona që për momentin gjenden jashtë vendit, ndërsa të dhënat për ta mund të jepen edhe nga persona të tjerë që nuk janë në rrethin e ngushtë familjar me ta. ESHS do të jetë institucioni i vetëm kompetent për këtë operacion dhe nuk do të ketë komisione, apo trupa të tjerë që do të marrin pjesë në të, siç ndodhi në vitin 2011.

ADEMI: DO TË ZHBËJMË PADREJTËSITË NDAJ KUADRIT SHQIPTAR

Me transferimet e punonjësve nga Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe punësimet e reja, përqindja e kuadrit shqiptar brenda ESHS-së pritet të tejkalojë 16 për qind deri në fund të këtij viti. Gjatë vitit 2018, në këtë institucion është arritur të bëhet avancimi i 16 punonjësve nga dy në tre shkallë, përkatësisht nga referentë të rinj në të pavarur, nga bashkëpunëtorë të rinj në bashkëpunëtorë e të lartë, e të tjera. Por ende në asnjë njësi apo sektor nuk ka drejtues shqiptar. "Çështja e avancimeve është ngritur si një nga çështjet më të rëndësishme dhe

prandaj do të vazhdojnë edhe në dy vitet e ardhshme. Po punohet për përmirësimin e të gjitha padrejtësive të bëra ndaj nesh gjatë viteve të kaluara. Shqiptarët tani në ESHS janë pjesë e çdo procesi të rëndësishëm dhe nuk lejoj të ngelemi të përjashtuar, siç ishte zakoni më herët. Sa u takon njësiteve dhe sektorëve dhe faktit se aty nuk ka asnjë udhëheqës shqiptar, patjetër e kam të kthehem pas në kohë, plot 10 vite nuk kishte as edhe një avancim të vetëm për shqiptarët dhe duke qenë në nivelet më të ulëta aty, është e pamundur ligjërisht që të emërtohen në udhëheqës", thotë Ademi.

PROBLEM ME KONKURENCËN JOLOJALE

"Në Maqedoni ka 68.000 hektarë sipërfaqe me grurë për dallim prej para 25 deri 30 viteve kur sipërfaqet arrinin 280.000 hektarë. Në Manastir, çmimi blerës për momentin është 11 deri 11.5 denarë që është shumë solide nëse merren parasysh edhe subvencionet. Gruri i blerë dërgohet kryesisht në Greqi dhe Shqipëri", theksoi Oroçanec

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 2 tetor - Prej 11 deri 11.5 denarë për një kilogram është çmimi blerës i grurit, por sasi të kryesisht eksportohen në Greqi dhe Shqipëri, thonë prodhuesit. Ndërkohë, përpunuesit importojnë miell serb sepse, sipas tyre, logjika e tregut është - çmimi më i mirë për cilësi më të mirë. Siç tha dje kryetari i

Kemi grurin tonë, por hamë bukë serbe



Odës së agro-biznesit pranë Lidhjes së Odave Ekonomike (LOE) Ognen Oroçanec, sipërfaqet po zvogëlohen, ndërsa prodhimtaria vazhdon të bie edhe pse kapacitetet për rritjen e saj ka. Po zvogëlohet edhe interesi për bujqësinë në përgjithësi. "Në Maqedoni ka 68.000 hektarë sipërfaqe me grurë për dallim prej para 25 deri 30 viteve kur sipërfaqet arrinin 280.000 hektarë. Në Manastir, çmimi blerës për momentin është 11 deri 11.5 denarë që

është shumë solide nëse merren parasysh edhe subvencionet. Gruri i blerë dërgohet kryesisht në Greqi dhe Shqipëri", theksoi Oroçanec. Të gjithë që i grumbulluan grurin dhe elbin para të reshurave, u shpreh Oroçanec, fituan cilësi të shkëlqyer.

Përpunuesit theksojnë se çmimi i miellit është rritur 30 për qind dhe është 240 deri 250 euro për një ton, përderisa vitin e kaluar ishte 180 euro, por te prodhuesit e

brumërave ende nuk ka shtrenjtim dhe për momentin janë më të lira në rajon dhe Evropë. "Kemi problem me konkurrencën jolojale të cilën e shkaktojnë kapacitetet më të vogla të cilat nuk i paguajnë tatumet dhe për shkak të kësaj janë më konkurruese. Në lidhje me miellin, reagojmë sipas kushteve të tregut. Duhet të jemi logjik dhe të mençur. Zgjidhja është gjithmonë cilësia më e mirë për çmimin më të mirë ose çmimi i mirë për cilësi më të mirë. Kjo është vendimtare. Nuk mund të hymë në atë se a është gruri nga Maqedonia, Serbia ose shtete tjera", theksoi Goran Georgievski nga "Special". Ai konfirmoi se jo vetëm mielli, por edhe gruri importohet. Sektori i agro-biznesit kërkon nga shteti subvencione të njëjta si në Evropë dhe grante nga 30 deri 90 për qind për kapacitetet përpunuese. Vlerëson se ekonomitë e mëdha janë shtytës të zhvillimit, por nuk është kundër mbë-

shtetjes për prodhimet e vogla, gjegjësisht për prodhimtarinë si veprimtari shtesë.

"Nuk dëshirojmë asgjë më shumë se subvencione, si në Evropë nga buxheti i të cilit brenda vitit ndahen nga 67 për qind për bujqësinë. Maqedonia duhet seriozisht të veprojë me bujqësinë ashtu si edhe të gjitha vendet e zhvilluara. Çka mund të bëhet me 10.000 euro aq sa është mbështetja për fermerët e rinj nëse e dimë se një traktor kushton së paku 250.000 euro?", pyet Oroçanec, duke shtuar se secila prodhimtari nën 50 hektarë është humbje. Në konferencën për shtyp u theksua edhe se bujqësia produktive dhe konkurruese tashmë nuk është e mundur pa zbatim të shkencës dhe teknologjive të reja, farë e certifikuar dhe plasman i parapërcaktuar. Oroçanec kumtoi se edhe disa lloje të grurit vendor, të Maqedonisë janë pranuar në Shqipëri, Greqi dhe Serbi.

Në afat prej tre muajve duke nisur nga nëntori i 2017 e deri në fund të janarit të vitit 2018 në Çair të Shkupit kanë ndodhur disa vrasje e dhjetëra incidente tjera të armatosura, ku fatmirësisht nuk ka pasur viktima në njerëz. Një pjesë tyre organet e rendit i kanë zgjidhur, e disa tjera jo. Shqetësimi më i madh i banorëve të kësaj ane mbetet vetëdija e ulët qytetarë dhe guximi i tyre që zënkat personale ti zgjedhin në rrugë

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 2 tetor - Brenda një viti Shkupin dhe rrethinën e kanë tronditur disa vrasje dhe përlëshje ku janë përdorur armë zjarri. Seritë e incidenteve me pasoja fatale fillimisht nisën në Çair, më pas u bartën në Hasanbeg, një lagje periferike e Shkupit dhe së fundmi vrasja e cila i shqetësoi banorët e kryeqendrës u regjistruar disa metra larg zyrave të Prokurorisë Speciale Publike, po në Shkup. Si rezultat i këtyre zënkave, gjatë periudhës së kaluar të vrarë kanë mbetur pesë persona, ndërsa mbi dhjetë qytetarë kanë shpëtuar të plagosur.

Vrasja e parë pas shumë kohës në Shkup, gjegjësisht në Çair, e cila vazhdon të mbetet e pazgjidhur, ishte likuidimi i Ismet Kokës. Rafalin dhe krismat e fundit të nëntori të vitit të kaluar vazhdojnë ti kujtojnë banorët e Fushë Tophanes, e cila njihet si një lagje e qetë urbane. Ky incident me pasoja fatale, ku pati të vrarë dhe të plagosur, e shtoi dozën e frikës te banorët për sigu-

KRONIKA TRAGJIKE E VRASJEVE

QYTETARËT NDJEHEN TË PASIGURT



VAZHDOJNË HETIMET, AUTORËT NË LIRI

Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, ka njoftuar policia e shteti gjendet në rrugë të mirë drejtë zbardhjes së vrasjes që javën e kaluar ndodhi në afërsi të Kopshtit Zoologjik. Autorët e vërtet të likuidimit të Naim Ajetit dhe Aleksandar Parapulovit, dhe plagosjes e një 19 vjeçari, siç njoftojnë nga MPB, ende nuk dihen. Megjithatë, ato shtojnë se punohet në vërtetimin e motivit të vrasjes. "Përkundër përgatitjeve për ditën e Referendumit, shërbimet përkatëse të policisë së shtetit me automatizëm kanë formuar një grup pune, i cili është marrë me vrasjen e cila ndodhi javën e kaluar në rrugën 'Frenklin Ruzvlet'. Në bashkëpunim me Prokurorinë, menjëherë pas

ndodhisë është kontrolluar vendi i ngjarjes, janë siguruar materiale, gjurmë që janë zbuluar që burojnë nga kryerja e veprës penale. Ndaj trupave të pa jetë është kryer obduksion. Për momentin është duke u kryer ekspertiza e të gjitha materilave të siguruar, përfshi edhe veturën ku kanë qenë të ndjerit. Njëkohësisht po ndërmerrin një varg masash zbardhjen e rastit. Gjatë ditëve të kaluara, në bisedë informative janë thirrur më shumë persona, me të vetmin qëllim zbulimin e motivit dhe autorëve të vërtet. Kemi avancim në procedurë hetuese. Megjithatë, kur të kemi rezultate konkret të njëjtat do ti shpërnda me opinionin", tha Spasovski.

rinë e tyre.

Shqetësimi i banorëve të Çairit u shtua edhe më tepër kur pas një jave, në fillim të dhjetorit të kaluar në rrugën Xhon Kenedi u regjistrua një vrasje tjetër. Kësaj radhe shënjestra ishte Burim Idrizi, një djalë i ri i cili me breshëri plumbash, në sytë e dhjetëra qytetarëve u vra përball Shkollës së Mesme "Cvetan Dimov"

në Çair. Pavarësisht faktit se organet e policisë vepruan në kohë që ky rast të zgjidhet dhe vrasësit të zbulohen, për opinionin e gjerë siguria në vend paraqet një rrezik prej problematikave kryesor që duhet zgjidhur nga institucionet përkatëse. Brengën e qytetarëve të anës së vjetër të Shkupit më së mirë e arsyeton fakti se pas vrasjes së Idrizit, disa

ditë më vonë në lagjen e Dizhoni ndodhi edhe një zënkë tjetër, kësaj radhe familjare, por që përfundoi me viktima në njerëz.

Kronika tragjike që përshkoi një afat prej tre muajve duke nisur nga nëntori i 2017 e deri në fund të janarit të vitit 2018 në Çair, ka regjistruar disa vrasje e dhjetëra incidente tjera të armatosura, ku fatmirësisht

nuk ka pasur viktima në njerëz. Incidente të ngjashme dhe vrasje gjatë periudhës së fundit po thuajse janë regjistruar në çdo cep të Shkupit, megjithatë shumica prej tyre ndodhin mes qytetarëve shqiptar. I tillë mendohet të jetë edhe rasti i fundit në Hasanbeg të Shkupit, ku me breshëri plumbash u sulmua një 22 vjeçar nga fshati Luboten. Organet e rendit duke raportuar për këtë ngjarje thonë se vetura e Llojit "mercedes" ka qenë e sulmuar nga persona të panjohur, por se të njëjtit mbi të kanë shtirë mbi 30 fishekë. Fati i madh shënjestra në këtë rast ka kaluar me lëndime të rënda trupore. Motivet dhe arsyet e kësaj ndodhie flitet se lidhen me hakmarrjen për një vrasje të ndodhur në fshatin Luboten në prill të vitit 2015.

Dhe, incidenti më aktual ku u përdorën armë zjarri, ku mbetën të vrarë dy person ndodhi mu në qendër të Shkupi. Elementi i përbashkët që e lidh këtë ngjarje me rastet e sipërpërmendura është se viktimat dhe të plagosurit janë të etnisë shqiptare. Kjo ngjarje tragjike e cila vazhdon të hetohet nga policia e Shkupit dhe prokuroria, mendohet të ketë lidhje me nëntokën e kryeqendrës, respektivisht me faktin se viktima Naim Ajeti, ka qenë vëlla i Xhelal Bellanocës, i cili vite më parë, në rrethana ende të panjohur u likuidua para çajtores së tij në fshatin Hasanbeg.

Ambasadori i Francës në Maqedoni, Kristian Timonie, duke folur për tregtinë me armë ilegale, theksoi se në sulmet terroriste që ndodhën në Paris në vitin 2015, një pjesë e armatimit vinte nga Ballkani Perëndimor. Sipas tij, lufta kundër grupeve kriminele dhe rrjeteve të terroristëve është e pajetërsueshme, sidomos tash kur ISIS-i në Irak dhe Siri është shpërndarë

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 2 tetor - Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe ato të BE-së duhet të rrisin kapacitetet e shkëmbimit të informacioneve në luftën kundër tregtisë me armë dhe eksplozivëve. Njëpërmjet intensifikimit të këtij bashkëpunimi, ambasadori i Francës në Shkup, Kristian Timonie, tha se lufta kundër tregtisë ilegale me armë do të jetë më e suksesshme. Në seminarin rajonal "Zbatimi i teknologjive të reja kundër tregtisë me armë", i cili fil-

FRANCA E RRIIT BASHKËPUNIMIN ME SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR

ARMËT E ISH JUGOSLLAVISË, SFIDË PËR BE-në



loi të martën, fjalim rasti pati edhe Ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Oliver Spasovski, i cili tha se lufta kundër të gjitha llojeve të krimit të organizuar paraqesin prioritet për Qeverinë dhe policinë e shtetit.

"Doemos nevojitet rritja e bashkëpunimit si në nivel rajonal ashtu edhe më gjerë. Posaçërisht është e nevojshme të vendoset një sistem i përshtatshëm i evidencës dhe kontrollit të armëve, përmes të cilit shërbimet tona do ta kenë më lehtë realizimin e procedurave për gjetjen e armëve eventuale që janë

shfrytëzuar për të kryer një vepër të caktuar penale, njëkohësisht edhe vetë kryerësin e kësaj veprë penale", tha i pari i policisë së shtetit, Oliver Spasovski. Mes tjerash, ai tha se Maqedonia si anëtare e OKB-së, në vazhdimësi po ndërmerr aktivitetet për realizimin e obligimeve që burojnë nga konventat relevante dhe dokumentet tjera nga sfera e kontrollit të armëve.

Ambasadori i Francës në Maqedoni, Kristian Timonie, duke folur për tregtinë me armë ilegale, theksoi se në sulmet terroriste që ndodhën në Paris në vitin 2015, një

pjesë e armatimit vinte nga Ballkani Perëndimor. Sipas tij, lufta kundër grupeve kriminele dhe rrjeteve të terroristëve është e pajetërsueshme, sidomos tash kur ISIS-i në Irak dhe Siri është shpërndarë. "Armët e kalibrit të vogël po ashtu shfrytëzohen për qërimin e hesapeve edhe në Francë. Kësisoj, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve janë të ekspozuar në rrezik. Tregtia me armë organizohet për shkak të sasisë së madhe të armëve ilegale që datojnë nga koha e Jugosllavisë, gjegjësisht rezerva e atyre armëve është në shitje. Më 13 korrik të këtij viti, në Maqedoni u realizua asgjësimi i 590 copave armëve dhe në këtë mënyrë u vërtetua se shteti i kush-ton rëndësi të madhe kësaj të keqe. Po ashtu, u vendosën mekanizma për luftë kundër tregtisë me armë. Njëkohësisht, edhe në Francë u organizua plan kundër armëve mbajtjeve pa leje. Shteti i Francës po realizon bashkëpunim të lartë me shtetet e Ballkanit Perëndimor,

siç janë Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe ky bashkëpunim duhet të intensifikohet po edhe në Maqedoni", tha ambasadori Timonie.

Në bazë të dhënave operative, siç potencoi ambasadori Timonie, shërbimet përkatëse e kanë më lehtë ti neutralizojnë grupet kriminele që merren me tregtinë jo legale të armëve.

Një iniciativë tjetër e shtetit Francës, të cilën e shpallti përfaqësuesi diplomatike në Shkup, është ofrimi i një sistemit balistik për afrim, për tu arritur një afërsi mes shteteve të BE-së dhe ato të Evropës Juglindore. Të dy këto sisteme pritet të vendosen në Serbi dhe Bosnje. Gjatë periudhës së fundit, në plan rajonal janë vendosur më tepër mekanizma, duke filluar nga SELECI, SESAK dhe OBSE, me çka përmes këtyre programeve mundësohet lehtësimi i bashkëpunimit në drejtim të sigurimit të masave kundër krimit të organizuar.

Përshpejtimi i rrugës euroatlantike të Maqedonisë pritet të gjallërojë edhe shfrytëzimin e aksioneve dhe obligacioneve si një nga burimet kryesore të financimit të punës së bizneseve në shtet, së bashku me kreditë që lëshohen nga bankat

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 2 tetor - Maqedonia si shtet i vogël me një sistem tradicional financiar ku bankat dominojnë në sistemin financiar, ende nuk e ka të zhvilluar sa duhet tregtinë e letrave afatgjate me vlerë. Kjo vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së investitorëve të huaj të shkaktuar si rrjedhojë e krizës politike në të kaluarën. Përshpejtimi i rrugës euroatlantike të Maqedonisë pritet të gjallërojë edhe shfrytëzimin e aksioneve dhe obligacioneve si një nga burimet kryesore të financimit të punës së bizneseve në shtet, së bashku me kreditë që lëshohen nga bankat. Kjo nënkupton se do të ketë rritje të interesimit si nga investitorët të huaj ashtu edhe vendor për shitblerjen e aksioneve të kompanive që punojnë në tregun vendor të kapitalit.

Nga Komisioni i Letrave me Vlerë që si organ rregullator mbikëqyr punën e Bursës së Maqedonisë thonë se tregut të kapitalit në Maqedoni i nevojitet një menaxhim më i mirë korporativ si dhe përkrahje e fuqishme institucionale që të ec rrugës së përvojave të suksesshme perëndimore.

Sipas numrit një të Komisionit të Letrave me vlerë, Nora Aliti, paqartësia politike apo pasiguria sidomos në vitet 2015 dhe 2016

TREGU I KAPITALIT NË MAQEDONI

NEVOJITET NJË MENAXHIM MË I MIRË KORPORATIV



patjetër se kanë ndikuar negativisht në tregun e kapitalit. Njëherazi besimi i investitorëve paraqet një faktor kyç në dinamikën e tregtisë së letrave me vlerë. Në vitin 2017 me stabilizimin e situatës politike tregu ka reaguar pozitivisht, ku në gjashtë muajt e parë të këtij viti shënohen rezultate më të mira në raport me tremujorin e tretë si rrjedhojë e paqartësisë që ndërlihet me referendumin. Megjithatë në total ky vit pritet të jetë një ndër vitet me rezultate më të mira të tregut të kapitalit në këtë dhjetëvjeçar.

"Zhvillimi më i madh i tregut të letrave me vlerë kërkon stabilitet më të madh politik dhe siguri juridike, ndërsa më vonë vijnë kushtet e tjera. Këto gjëra më lehtë do të sigurohen përmes hyrjes në NATO

dhe BE. Në këtë mënyrë investitorët vendor dhe të huaj do të kenë garanci se kapitali i tyre në Maqedoni është i sigurt. Pa këto arritje, të gjitha angazhimet lidhur me tregun e kapitalit, nuk do të japin efektin e dëshiruar", thekson Aliti.

Sipas saj, kompanitë në vend akoma në mënyrë të pamjaftueshme vendosin që të shfrytëzojnë tregun e kapitalit si mënyrë relative të lehtë, dhe e lirë që të sigurojnë kapital të freskët për financimin e projekteve të tyre. Krahas angazhimeve të mëparshme nga ana e Komisionit të letrave me vlerë, në drejtim të rezultateve më të mira në tregun e letrave me vlerë në të ardhmen do të ndërmerren më shumë hapa të tjerë siç janë mbështetja dhe përkrahja e targetuar për shoqëri të caktuara

që në mënyrë analitike do t'ju ndihmohet të inkuadrohen në tregun e kapitalit. Veç më janë detektuar biznese me prodhime apo shërbime të caktuara që janë të njohura në opinion për të cilat supozohet se ka interes nga ana e investitorëve. Njëherazi viti 2019 do të shpallet "viti i IPO". Me fjalë tjera do të ndihmohen bizneset në aspektin e dokumentacionit që të fitojnë kapital përmes mekanizimit në tregut primar. IPO nënkupton se përmes ofertës publike të aksioneve, kompanitë kalojnë nga forma e mbyllur më formë të hapur të shoqatave aksionare. Me procedurën IPO faktikisht kryhet korporativizimi i kapitalit të firmës, që pasqyrohet përmes numrit dhe vlerës së aksioneve.

Ulet përqindja e kredive të këqija

Shkup, 2 tetor - Të dhënat e fundit të Bankës Popullore të Maqedonisë (BPM) për vitin 2018 rezultojnë se ka ardhur deri te për-mirësimi i treguesve përmes të cilëve përcillet sistemi bankar në Maqedoni dhe kjo është falë rezultateve për stabilizim me theks të posaçëm - ulja e kredive jo-funksionale, gjegjësisht kreditë që nuk mundet bankat t'i paguajnë nga qytetarët dhe kompanitë. Në muajin prill dhe maj të vitit 2018, shkalla e rritjes së kredive korporatave përsëri ka shënuar rezultate pozitive. Në nivel vjetor, përfundimisht më kuarta-lin e parë të vitit 2018, mbetet konstatimi se rritja e kredive ndaj amvisërive është shumë më solide sesa nga sektori korporativ ose firmave, gjegjësisht për 9.8 për qind kemi rritje të kredive të amvisërive kundrejt 2.6 për qind për kreditë e këqija. "Me këtë sh-trirje, probabiliteti i rrezikut kreditor mbetet i rrezikut të veçantë për sistemin bankar, në veçanti kur merret parasysh se rritja e përgjithshme e kredive e zbutë shkallën e rritjes së kredive jo-funksionale apo të kredive të kë-qija. Historikisht e kemi shkallët më të ulët dhe jo të ndryshueshme të kredive të këqija të amvisër-ive prej 2.4 për qind, e gjithë kjo është falë rritjes së kredive në këtë sektor. Shkalla e kredive pro-blematike ndaj shoqatave jo fi-nanciare apo firmave që nuk pu-nojnë me qarkullim ditore është zvogëluar dhe në fund të kuarta-lit të parë, kap shifrën prej 7.8 për qind. Pjesëmarrja e përgjithshme e kredive të këqija për amvisëritë dhe shoqatave jo financiare është zvogëluar për 1.2 për qind të pikë-ve netre mujorin e parë të këtij viti duke u ulur kështu në 5,1 për qind", thuhet në kumtesën e fun-dit të BPM-së. (Z.V)

FILLON PROCESI PËR REFORMIM TË DSK-SË

TRE MODELE PËR REFORMËN E SHËRBIMIT SEKRETE

Shkup, 2 tetor - Tre modele janë në sipërfaqe për zbatimin e reformave të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, si pjesë e reformave të shërbimeve të sigurisë-zbulimit dhe tentimeve për përfundim të ndikimeve partiake, politike dhe të gjitha të tjerave ndaj punës së këtij sektori. Këtë e paralajmëruan në konferencën për shtyp ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski dhe drejtori i DSK-së, Goran Nikollovski. Spasovski theksoi se që sot në mbledhje qeveritare do të parashtrijë informatë për reformat e ardhshme, do të formohet

grup punues i cili do ta zbatojë tërë procesin e konsultimeve me të gjithë faktorët të cilët janë relevantë në këtë segment. Është paraparë konsultimet të fillojnë nga ky muaj dhe të përfundojnë deri më 15 nëntor.

"Në periudhën në vijim do ta zgjedhim modelin, sipas të cilit do të zhvillohet reforma e DSK-së. Në mbledhje të Qeverisë sot do të parashtrijë informatë, me të cilën do t'i arsyetoj shkaqet për një reformë të këtillë. Është paraparë MBP të mbajë disa konsultime dhe debate me faktorë relevantë, pas çka do

të zgjidhet modeli më adekuat. Këtë proces do ta udhëheqë grupi punues, i cili do të formohet nga institucionet kompetente shtetërore, por edhe me përfaqësues nga sfera akademike dhe shoqëria qytetare", sqaroi ministri Spasovski pas përfundimit të konsultimeve, konkludimet do të shoqërohen në Qeveri me plan adekuat të aksionit.

"Qëllimi është të fitojmë shërbim i cili do të bazohet në standarde të larta profesionale, respektim të kodit etik dhe metodave bashkëkohore të punës dhe vepri-



mit, shërbim i cili do të jetë i mbrojtur nga ndikimet negative politike dhe detyrë e vetme e të cilit do të jetë t'i mbrojtë sigurinë e qytetarëve", theksoi Spasovski. Ai përkujtoi se keqpërdorimi i shërbimeve të sigurisë-zbulimit, posaçërisht të DSK-së shkaktoi krizë serioze politike në vend dhe e prishi imazhin e demokracisë. "Anëtarësimi në BE dhe NATO nënkupton ekzistim të shërbimeve, të cilat do të jenë të barabarta me shërbimet e vendeve aleate", tha ministri. Në

suaza të projektit të përpunuar me DIKAF është bërë analizë e kësaj reforme, ekzistojnë tre modele, ndërkaq Spasovski pa i paraqitur hollësitë për to përmendi se tani për tani nuk preferohet asnjëri prej tyre. "Do t'i shqyrtojmë në periudhën e konsultimeve, do të bisedojmë me gazetarët, korin diplomatik, sektorin akademik dhe në fund do të vendosim. Dëshirojmë t'i shohim përparësitë dhe dobësitë e secilit prej tyre", shtoi ai. (Q.A)

DISKRIMINOHEN FAMILJET
MENJË PRIND

NË PRITJE TË KUJDESIT INSTITUCIONAL



Në Maqedoni, edhe pse janë të rregulluara ligjërisht me disa akte ligjore, familjet dhe raportet mes anëtarëve të tyre, si dhe mbrojtja e familjes, sërish familjet me një prind nuk pranohen si kategori ligjore, që ndikon në statusin social, në integrim dhe mirëqenie

Koha

Delvina KËRLUKU

Shkup, 2 tetor - Numri i madh i familjeve me një prind përbën shqetësim, sepse prindërit e vetëm dhe fëmijët e tyre mund të hasen në probleme të shumta, si stresi, problemet ekonomike dhe një gjendje shoqërore e pafavorshme. Qeveria e mëparshme në Maqedoni, siguroi disa ndihma për këto familje, por nuk kanë qenë të mjaftueshme. Ndërsa, programi i punës së Qeverisë së tanishme ka paralajmëruar se do të përkrah familjet me nga një prind duke mundësuar orar fleksibil të punës për prindin si dhe lirim nga një pjesë e obligimeve publike (taksë, transport publik, kompensim për çerdhe). Por, përqendrimi do të jete te familjet me nga një prind, që kanë pagë më të ulët se paga mesatare. Po ashtu, do të krijohet Fond shtetëror për pagesën e kujdesit ligjor për fëmijët. Në rast se prindi nuk e paguan kujdesin në kohë, Fondi do të paguaj mjetet të cilat më pas do t'i inkasojë nga mos paguesi. Me këtë, do të garantohet pagesë në kohë e të gjitha kujdeseve ligjore nga ana e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Në mënyrë shtesë, do të ofrohen shërbime falas për familjet me nga një prind me të hyra nën mesataren, në nivel lokal për përkrahjen gjatë funksionimit të përditshëm të këtyre qytetarëve.

Situata me diskriminim e familjeve me një prind është shqetësuese, edhe pse këto familje janë gjithmonë në rritje e sipër në nivel lokal dhe ndërkombëtar, thotë Doroti Pačkova nga organizata qytetare për zhvillimin e të drejtave të familjeve me një prind, "One Can" (Një mundet).

Prindi i një fëmije E.S. thotë se deri në moshën 3 vjeçare i është ofruar ndihmë nga shteti, më vonë nuk ka marrë asnjë përkrahje. Ajo, e ka rritur vetë fëmijën, meqë burri i saj ka vuajtur burgun në Maqedoni dhe më vonë jashtë vendi (Itali).

"Që kur lindi djali, deri në moshën 3 vjeçare kam përfitur ndihmë në shumë prej 3000 den. Më vonë familja e burrit ka marrë ndihmë sociale dhe jemi mbajtur me shumën e vogël së asaj ndihme. Kur u larguam nga familja e burrit, nuk kishim

asnjë ndihmë. Tani, djali është në moshën 16 vjeçare, nuk ka pasur asnjë përfitim nga shteti, përpos që sivjet qeveria miratoi rregulloren që autobusi, transporti për në shkollë të jetë falas, por kjo u përket të gjithëve, si fëmijës me një prind ashtu edhe fëmijës me dy prind", thotë nëna E.S. për gazetën KOHA. Edhe pse është zhvendosur nga vendi i lindjes në Shkup, për të gjetur një punë, që do ti sigurojë të ardhura fëmijës, E.S. shton se nuk mund ti mbulojë shpenzimet e jetës, aq më shumë kur fëmija ka shumë shpenzime në shkollë dhe në jetën e përditshme.

Familjet me një prind nuk kanë lirim as në agjencitë turistike, pasi edhe aty kërkohen dy prindër që të mund fëmija të kalojë falas apo që të paguhet një shumë më të vogël në total edhe për të rriturin. Por, nuk ka lirim në asnjë institucion tjetër shtetëror, si muzetë, teatro, filarmoni, etj.. Disa agjenci në qytetin e Shkupit thonë se sipas rregullave të hotelerive për kapacitetet akomoduese, agjencitë ofrojnë mundësi për akomodim në dhoma të ndryshme, në varësi nga numri i personave.

Ministria për punë dhe politikë sociale thotë se nuk ka kompetenca që t'i detyrojë institucionet shtetërore dhe firmat private t'u bëjnë lirim familjeve me një prind. Që atje shtojnë se familjeve me një prind u janë dhënë më shumë mundësi në pjesën e realizimit të së drejtës së mbrojtjes sociale në përputhje me ligjin për mbrojtje sociale.

"Familjet me një prind kanë të drejtë të përdorimit të ndihmës së vazhdueshme

financiare për prind të vetëm dhe fëmijë deri në moshën tre vjeçare në rast se nuk janë të siguruar materialisht. Gjithashtu, ministria e Punës dhe Politikës Sociale në nivel vjetor, në vazhdimësi e implementon projektin për pushime verore dhe dimërore falas për fëmijët e familjeve me rrezik social dhe fëmijëve që janë përdorues të shtesës së veçantë, në të cilën përfshihen edhe familje me një prind që u mundësohet përdorimi i këtij shërbimi falas", thonë nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Nga komiteti i Helsinkit në Maqedoni thonë se raporti diskriminues ndaj familjeve me një prind, në baza martesore dhe familjare, për fat të keq, është një fenomen i shpeshtë.

"Bëhet fjalë për diskriminim direkt, të shumëfishtë të familjeve me një prind prej një nëne të vetme dhe një fëmije për qasje të shërbimeve publike (qasje në muze), në bazë të statusit martesor dhe familjar, është treguesi më i mirë për mos prezencën e drejtësisë dhe sensibilizimit të institucioneve ndaj familjeve me një prind. Ky rast tregon diskriminim jo vetëm ndaj familjeve me një prind, por edhe ndaj familjeve strehuese dhe atyre që kanë nën kujdestarinë e tyre fëmijë", thonë nga komiteti i Helsinkit. Në Maqedoni, edhe pse janë të rregulluara ligjërisht me disa akte ligjore, familjet dhe raportet mes anëtarëve të tyre, si dhe mbrojtja e familjes, sërish familjet me një prind nuk pranohen si kategori ligjore, që ndikon në statusin social, në integrim dhe mirëqenie.

UDHËZUES PËR FËMIJËT DHE PERSONAT ME AUTIZËM

Me promovimin e Udhëzuesit për program muzeor për fëmijët/personat me autizëm dhe familjet e tyre, Muzeu i Luftës maqedonase sot e përfundoi projektin "Muze të hapura", qëllimi i të cilit është t'i përfshijë në ngjarjet kulturore kategoritë e ndjeshme dhe personat me pengesa në zhvillim. Udhëzuesi është i pari i këtij lloji në Maqedoni dhe është publikuar në tre gjuhë. Është krijuar për t'u ndihmuar

punonjësitë të muzeve të krijojnë programe dedikuara për fëmijët/personat të cilët janë në spektrin e autizmit dhe familjeve të tyre. Sipas autorëve - Jasmína Troshanska, Ana Shikaleska dhe Daniella Trajkova-Kërstiq, me mbështetje adekuate këta persona mund të bëhen pjesë aktive e shoqërisë dhe t'i shfrytëzojnë përfitimet nga resurset në institucionet kulturore në shtet.

KRONIKË

Përmbysset vetura, lëndohen dy emigrantë

Sipas informacioneve të SPB-Veles, mëngjesin e djeshëm rreth orës 6:30 në autostradën Gradsko-Veles një automjet me udhëtarë e tipit "Reno Espejs" me tabella të Strumicës, i drejtuar nga person i panjohur ka goditur në gardhin mbrojtës dhe është përmbysur. Pas aksidentit, shoferi ka ikur nga vendi i ngjarjes, ndërsa në automjetin janë gjetur 13 emigrantë ku dy kanë qenë të lënduar. Ata janë dërguar në spitalin e përgjithshëm në Veles, ndërsa për shkak të karakterit të lëndimeve janë transferuar në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza" në Shkup. Siç ka njoftuar zëdhënësi i SPB-Veles, Verolub Dodevski, po ndërmerren masa për zbardhjen e rastit, ndërsa mbikëqyrje në vendin e ngjarjes ka bërë ekip nga SPB e Velesit.

Edhe një rrahje gjatë natës në Tetovë

19 vjeçari nga Tetova me iniciale R.T dhe po ashtu një tjetër 19 vjeçar me iniciale Z.D nga fshati Bozovcë, të hënën mbrëma rreth orës 23 e 30 minuta kanë denoncuar dhunë që ndaj tyre e kanë ushtruar personat M.E dhe M.M, që të dy 27 vjeçar si dhe një person tjetër, me të cilët janë takuar në rrugën "107" në Tetovë. Këta të fundit dy herë i kanë sulmuar me grushta dhe me dorezë thike, duke u shkaktuar lëndime trupore. Pasi kanë ndërhyrë të tjerët për të ndaluar rrahjen, tre personat kanë ikur nga vendi i ngjarjes. Policia menjëherë ka arrestuar të tre personat dhe do të ketë edhe padi adekuate.

Incident para një lokali në Tetovë

Në orët e para të mëngjesit të ditë së martë, dy tetovarë të moshës 22 dhe 25 vjeçare me iniciale L.M kanë denoncuar se në orën 4 e 30 minuta, para objektit të tyre në rrugën "Bllagoja Toska", janë sulmuar fizikisht nga dy persona edhe atë nga A.I. 28 vjeçar dhe I.M. 38 vjeçar dhe një person tjetër nga Tetova. Sipas policisë, personi me iniciale A.I. dy herë e ka prishur rendin dhe qetësinë publike me kërcënime dhe thyerje të inventarit të lokalit. Të denoncuarit me grushta dhe shishe u kanë shkaktuar lëndime trupore, ndërsa dy prej tyre janë arrestuar nga ana e policisë, ndërkaq personi i tretë ka arritur që të ikë dhe policia është në kërkim të tij.

Rrahje për përparësi kalimi

38 vjeçari R.S nga fshati Padalishtë i Komunës së Gostivarit ka denoncuar se të hënën mbrëma në rrugën "Beliçica" në Gostivar, ku ka qenë me disa persona, fizikisht është sulmuar nga tre persona nga fshati Llakavicë, gjegjësisht babai dhe dy djemtë. Sulmit i ka paraprirë një zënkë rreth përparësisë së kalimit, ndërsa sulmuesit kanë shfrytëzuar edhe shkopinj gome dhe shufra prej metali. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Aktivistëve ekologjik dhe organizata joqeveritare vlerësojnë se deri më tani duhej të merreshin masa konkrete lidhur me ndotjen e ajrit, pasi siç thonë ata, si gjithmonë, do të jetë e pamundur të kontrollohet ndotja e ajrit në mesin e vjeshtës dhe në dimër kur ndotësit janë më aktiv

MINISTRIA E MJEDISIT SHPËRFILL ORGANIZATAT JOQEVERITARE

ASNJË PLAN PËR NDOTJEN E AJRIT



përgjigje konkrete nga MMJPH dhe do të insistojnë në marrjen e përgjigjeve qoftë nevoja edhe do të organizojnë protesta. Nga Koalicioni O2 mes të tjerash u shprehën se kishin përgatitur dokument me propozime të ndryshme lidhur me zgjidhjen e problemit për ndotjen e ajrit dhe në përgjithësi problemeve ekologjike, por edhe për këtë nuk kishin marrë asnjë përgjigje nga ministria. Sipas tyre, mund të ketë dy arsye që nuk ka përgjigje: ose nuk janë të përgjegjshëm për ndotjen e ajrit, ose nuk i marrin seriozisht kërkesat dhe mendimet e qytetarëve për këtë problematikë që po dëmton rëndë shëndetin e tyre.

"Kishim dy-tre takime, mirëpo që në thelb nuk u punua asgjë. U bënë se gjoja po ndërmarrin hapa për zgjidhjen e problemeve, por që nuk i mbaruan. Ishim të durueshëm për të parë nëse punohet diçka, mirëpo as seancë qeveritare nuk kishte për këtë punë. Ndoshta ka pasur, por nuk jemi të njoftuar. Nuk është i njoftuar askush", thotë Nevena Georgievska nga Koalicioni O2.

Ndryshe, vite me radhë, ndotja e tmerrshme e ajrit është regjistruar në më shumë qytete të vendit, si në Shkup, Tetovë, Manastir, Kumanovë dhe në vende tjera.

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 2 tetor - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinorë duket se nuk ka një plan konkret si ta pengojë dhe ndalojë ndotjen e ajrit që, kryesisht gjatë vjeshtës dhe stinës së dimrit, rrit grimcat e dëmshme toksike PM10. Ankesat drejtuar kësaj ministrie vijjnë kryesisht nga organizatat joqeveritare që merren me ndotjen e ajrit, ndërkohë që shpërfillen dhe mediat, të cilët duhet të presin me muaj për të marrë përgjigje rreth kësaj problematike.

Madje, edhe pyetjet e mediave, ashtu sikurse të gazetës KOHA, nuk marrin përgjigje lidhur me paralajmërimet se po përgatitet Strategji për mbrojtje nga ndotja e ajrit. Aktivistëve ekologjik dhe

organizata joqeveritare vlerësojnë se deri më tani duhej të merreshin masa konkrete lidhur me ndotjen e ajrit, pasi siç thonë ata, si gjithmonë, do të jetë e pamundur të kontrollohet ndotja e ajrit në mesin e vjeshtës dhe në dimër kur ndotësit janë më aktiv.

Ndotja e ajrit definohet si prani e substancave toksike dhe kimikateve në ajër, në një sasi që paraqet rrezik për shëndetin. Në bazë të dhënave, Maqedonia radhitet ndër vendet e para në Evropë për ndotjen e ajrit dhe vdekshmërinë e popullatës nga ndotja. Në disa raste madje, Shkupi dhe Tetova kryesuan listën duke u radhitur ndër vendet e para në botë për

ndotje të ajrit. Kufiri maksimali i përcaktuar nga Bashkimi Evropian për praninë e grimcave PM10 në ajër është 50 mikrogramë në periudhë prej 24 orësh. Ky numër kishite rritje në përmasa të mëdha vitet e fundit dhe shkonte deri në më shumë se 900 mikrogramë PM10, që është rritje më shumë se 40 herë nga ndotja e lejuar. Javët e fundit, njësitë matëse në Shkup shënuar 35 herë më shumë rritje të ndotjes së ajrit nga e lejuara.

Për këtë gjendje të jashtëzakonshme vazhdimisht kanë reaguar organizatat joqeveritare në mënyra të ndryshme, duke propozuar edhe metoda për parandalimin e ndotjes së ajrit, mirëpo që si-

pas tyre, nuk u morën në konsideratë. Shoqata jo qeveritare Eko-iniciativa dhe Koalicioni O2, drejtuan një sërë pyetjesh deri tek organet kompetente, njëkohësisht publikuan analiza dhe dokumente lidhur me ndotjen e ajrit.

Ata për gazetën Koha sqaruan se kishin dërguar disa pyetje në Ministrinë e Ekologjisë lidhur me ndotjen e ajrit, mirëpo ende nuk kanë marrë përgjigje. Kjo është edhe arsyeja që Koalicioni O2 i nxori në opinion pyetjet të cilat ishin drejtuar deri tek Ministria përkatëse.

Edhe pse pyetjet nuk janë me karakter publik, nga Koalicioni O2 theksuan se ka muaj që presin

MBETJET NGA MATERIALET NDËRTIMORE PA LOKACION ADEKUAT

POLLOGU NË HALL ME MBETURINAT NDËRTIMORE

Banorët e Reçicës së Vogël ankohen se situata me vërshimet e vitit 2015 mund të përsëritet edhe tani, pasi hedhja e mbeturinave të forta në kthesën për në fshatin Rasadishte vazhdon edhe më tej



"Të gjitha ndërtimet që janë bërë në Tetovë, materialet nga prishjet e objekteve dhe që kanë ngelur nga ndërtimet, janë hedhur tek kthesa për në fshatin Rasadishte dhe vërshimet e fundit na sollën të gjitha ato mbeturina këtu në rrugë dhe në shtëpitë tona. Është dashur që institucionet kompetente të parandalojnë këtë dukuri, pra përgjegjësi kanë edhe qytetarët edhe institucionet", thonë banorët të Reçicës. Aktualisht, për shkak të mungesës së një deponie për mbetje të forta, qytetarët gjatë ndërtimeve që kryejnë nëpër pronat e tyre, materialet i nxjerrin pranë kontejnerëve. Në shumë pika grumbullimi të mbeturinave në qytet mund të shihen mbeturina amvisërie dhe materiale të forta.

Krahas kësaj, tashmë disa vite është krijuar edhe shprehje që mbeturinat e këtilla të hidhen edhe në vende periferike, si në afërsi të varrezave myslimane, në afërsi të lumit Shkumbin në pjesën më të lartë, afër varrezave ortodokse në lagjen Kolltuk dhe në përgjatë rrugës Tetovë-Falishtë.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 2 tetor - Rajoni i Pollogut vazhdon edhe më tej të mos ketë deponi për mbetjet e forta apo materialet ndërtimore. Pikërisht këto materiale që ishin hedhur në kthesën e fshatit Rasadishtë, për në Kodrën e Diellit, ishin kthyer në tmerr gjatë vërshimeve të gushtit të vitit 2015. Të gjitha këto materiale që ishin hedhur atje, sërish uji i kishte sjellë në Reçicë të Vogël, duke shkaktuar dëme të mëdha

materiale në këtë lagje të Tetovës e që ndodhet poshtë fshatit Rasadishtë. Gjatë asaj periudhe, për zgjidhjen e problemit premtim kishin dhënë Ministra e Mjedisit, kryeministra dhe pushteti lokal, por edhe tre vite më pas, ende nuk ka asnjë lëvizje. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, kishite deklaruar ditë më parë se kjo çështje do të fillojë të trajtohet pas përfundimit të deponisë regjionale Rusino. I paqartë ka qenë edhe deklarimi i ministrit të Ekologjisë, i cili ka theksuar se deponi të këtil-

la do të duhet të ndërtohen në bazë të Planit nacional për trajtimin e mbeturinave, por pa përgjigje nëse ka një plan edhe për Tetovën. Në Komunë theksojnë se zgjidhje më e mirë është që të ketë një deponi të përbashkët për të gjithë komunat, ku do të hidheshin mbeturinat e materialeve ndërtimore.

Nga ana tjetër, shumica e Komunave të Pollogut nuk kanë deponi të veçanta për hedhjen e mbeturinave nga materialet ndërtimore. Madje, lokacion të

veçantë nuk ka as Komuna e Tetovës. Nga ndërmarrja Publike Komunale Tetovë-Tetovë thonë se janë në hall me këtë dukuri, sepse materialet ndërtimore hidhen në vendet tek mbeturinat e zakonshme dhe më këtë, po dëmtohen kontejnerët, por edhe haset në vështirësi gjatë transportit. Banorët e Reçicës së Vogël ankohen se situata me vërshimet e vitit 2015 mund të përsëritet edhe tani, pasi hedhja e mbeturinave të forta në kthesën për në fshatin Rasadishte vazhdon edhe më tej.

Koha për paqe me ISIS-in dhe Al Kaedën?



Nga
Martha CRENSHAW

Pas gati 17 vjetësh fokusim tek kërcënim i terroristëve, komuniteti amerikan i mbrojtjes, nën presidentin Donald Trump, e ktheu vëmendjen ndaj shteteve të fuqishme. Por kjo mund të jetë diçka e përkohshme: terrorizmi i grupimeve xhihadiste, mbetet ende një kërcënim i fuqishëm.

Më së paku, e ardhmja ka të ngjarë të sjellë më shumë konflikte, që kombinojnë terrorizmin transnacional dhe luftën civile, më shumë bashkëpunim midis xhihadistëve dhe rebelëve lokalë jo xhihadistë, dhe më shumë zgjerim të "universit" xhihadist. Do të jetë e pamundur zhdukja e terrorizmit përmes forcës ushtarake, sikurse Shtetet e Bashkuara duhet ta kenë mësuar tashmë shumë mirë. Por alternativat e mundshme ndaj menaxhimit ose frenimit të kërcënimit, janë të pakta. Prandaj, SHBA-ja mund të jetë ende në kohë, për të shqyrtuar mundësinë e bisedimeve. Shtetet e Bashkuara, janë të gatshme të mbështesin zhvillimin e bisedimeve me talebanët afganë. Vlen të shqyrtohet, nëse e njëjta frymë mund të shtrihet në grupe të tjera të lidhura me Al Kaedën apo edhe me Shtetin Islamik. Numri i konflikteve që përfshijnë grupet rebele xhihadiste, të cilat luftojnë për të përmbysur regjimet në pushtet, është rritur vazhdimisht gjatë dekadave të fundit.

Ndërhyrja ushtarake në shumicën e vendeve myslimane, që datojnë nga pushtimi sovjetik i Afganistanit në 1979, Lufta e Afganistanit pas 2001-it, dhe më pas pushtimi amerikan i Irakut në vitin 2003, krijoi mundësi që xhihadistët të luftojnë pushtuesit e huaj dhe klientët e tyre lokalë. Vlen të kujtohet, se Al Kaeda filloi si një lëvizje për t'i rezistuar pushtimit sovjetik të Afganistanit, dhe fitoi famë, duke kundërshtuar ftesën e Arabisë Saudite dhe Shteteve të Bashkuara për të dërguar trupa për të mbrojtur mbretërinë nga Iraku në vitet 1990.

Pasi Al Kaeda e solli luftën në Perëndim më 11 shtator 2001, ndërsa Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj goditën me atë që ata e quajtën "lufta globale ndaj terrorit". Por ky konflikt, mobilizoi përkrahësit e xhihadit, po aq sa i ndëshkoi apo i dekurajoi. Në fakt, ajo ndihmoi në nxitjen e rritjes së Al



Kaedës. Dhe si për ironi, një nga degët e para të formuara në Irak pas vitit 2003 ishte paraardhëse e Shtetit Islamik, që në fund pushtoi Irakun dhe Sirinë në vitin 2014. Një degë tjetër, e themeluar në vitin 2007, ishte Al Kaeda në Magrebin Islamik e xhihadistëve algjerianë, dhe që tani është një burim përçarjeje mes Afrikës së Veriut dhe rajonit të Sahelit. Pranvera Arabe, u dha grupeve terroriste më shumë mundësi për të fituar luftën e tyre. Për shembull, trazirat që nisën në Siri në vitin 2011, e lejuan Shtetin Islamik të ngrinte një Kalifat territorial në territoret e Irakut dhe Sirisë. Marshimi ush-

tarak me një shpejtësi të rrafshme përballë një ushtrie irakiane të stërvitur dhe të armatosur nga amerikanët, ishte mbresëlënëse.

Edhe pse ambicjet territoriale të grupit mund të jenë sabotuar, operacionet kryesore luftarake përfunduan vetëm këtë vit, dhe ushtria amerikane thotë se fushata kundër Shtetit Islamik është në fazën e saj përfundimtare. Por Shteti Islamik, ka ende rreth 30.000 luftëtarë në Irak. Kontributi i tij më i qëndrueshëm i xhihadit mund të shpallja e Kalifatit, pasi sado i dobët, ai frymëzoi terrorizmin dhe tërhoqi luftëtarë të huaj nga e gjithë bota. Ndonëse kauza

ISIS është zotuar të vazhdojë luftën e tij, dhe ka bërë thirrje për sulme të reja në Perëndim. Dhe Al Kaeda dhe rrjeti i saj i aleatëve, do të përfitojnë nga rënia e rivalit të tyre më të shquar në Lindjen e Mesme. Ndërkohë, vazhdojnë shumica e problemeve themelore, që çuan në ngritjen e organizatave xhihadiste. Nuk ka një përgjigje të thjeshtë për t'u vënë në zbatim, përballë një kërcënim kaq kompleks, të shtrirë dhe të paqëndrueshëm. Por vlen të merren në konsideratë të gjitha opsionet, duke përfshirë negociatat me palët e zgjedhura



rebele është në rënie të ndjeshme në Siri, xhihadistët janë akoma lojtarë të mëdhenj. Grupet lokale kanë një prani të fortë në Afganistan, Algjeri, Bangladesh, Egjipt, Indonezi, Irak, Libi, Mali, Nigeri, Nigeri, Pakistan, Filipine, Tunizi, Somali dhe Jemen. Ndersa sulmues të saj kanë goditur Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Spanjën, Turqinë, Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Rusinë dhe objektiva të tjerë.

Por shumë ndarje dhe mosmarrëveshje të tjera, i përcajjnë xhihadistët. Lufta e brendshme e pushtetit e minon unitetin, ashtu si mosmarrëveshjet doktrinale dhe strategjike. Për shembull, Al Kaeda këmbënguli se deklarata e Shtetit Islamik për një kalifat në vitin 2014, ishte diçka e parakohshme. Edhe xhihadistët e përkushtuar, që bien dakord se dhuna është thelbësore për të mbrojtur Islamin kundër Perëndimit, dhe se demokracia është në thelb jo-Islamike, kundërshtuan barbarizmat e ISIS-it. Ndërkohë, Al Kaeda, ka përjetuar ndarjet e saj të brendshme.

Në Siri, besnikët origjinale të Al-Kaidës që përbënin fronin Al-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 2 tetor | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Nusra, u ndanë nga qendra e Al Kaedës në vitin 2016, mbi çështjen nëse lufta duhet të përqendrohet në armikun e "afërt" ose të "largët". Ndërsa Al-Kaeda kishte mbrojtur gjithmonë një përpjekje revolucionare ndërkombëtare të xhihadit, dega e saj siriane preferonte të përqendrohej në Siri. Kjo mungesë e unitetit midis xhihadistëve, mund të interpretohet si një shenjë dobësie, dhe qeveritë shpesh përpiqen të mbjellin grindje në radhët e kundërshtarit. "Përça dhe sundo", është një slogan i dobishëm. Por në fakt, konkurrenca midis kryengritësve rivale ose fraksioneve terroriste, i bën shpesh konfliktet më të vështira për t'u zgjidhur. Një alternative, është të përpiqesh të zgjidhësh shkaqet rrënjësore të problemit, duke zhdukur kushtet që e bëjnë xhihadin tërheqës. Por edhe nëse mund të identifikohen shkaqet e shumta politike, ekonomike dhe shoqërore të dhunës, trajtimi i tyre është një përpjekje e kushtueshme, që kërkon shumë durim dhe këmbëngulje, të cilat administrata aktuale në SHBA, i ka me pakicë.

Në këto kushte, negociatat mund të jenë një opsion i mundshëm. Pikëpamja tradicionale, është se xhihadistët janë në përgjithësi kundër bisedimeve. Për shembull, Daniel Benxhamin dhe Stiven Sajmën, të dy ish-zyrtarë qeveritarë dhe autorë të librit të vitit 2003 "Terrori i shenjtë", argumentuan se terroristët e sotëm nuk duan një vend në tryezë; ata duan ta shkatërrojnë atë. Dhe në fakt, disa negociata janë krejtësisht të kota. Në Siri, grupet më ekstremiste të xhihadit hodhën poshtë çdo kompromis, duke përfshirë edhe armëpushimet për të lejuar evakuimet e civilëve. Megjithatë, disa grupe relativisht të moderuara brenda kampit të përgjithshëm të xhihadit, kanë bërë marrëveshje. Në fakt, Ahrar Al-Sham (një grup që nganjëherë është aleat i Frontit Al Nusra) është bashkuar me Turqinë për negociata me Rusinë dhe Iranin. Dhe madje edhe përfaqësues të linjës së ashpër të Frontit Al Nusra janë ndarë, nëse do të bashkëpunonin apo jo me përpjekjet e Turqisë për të bashkuar rezistencën siriane. Përveç kësaj, organizatat rebele nganjëherë mund të anshkalohen dhe dëmtohen, nëse ofertat pajtuese u bëhen anëtarëve individualë. Në luftën civile në Algjeri, qeveria algjeriane ofroi amnisti individuale për rebelët, duke bërë që shumë njerëz të dezertorin dhe kalonin me shtetin, ose të braktisnin luftën.

Përballë një ofensive të fortë ushtarake, organizata e zvogëluar u bë edhe shumë brutale, derisa u mënjanua nga brenda nga udhëheqës të cilët kundërshtojn vrasjen e myslimanëve të tjerë. Ishte pikërisht ai momenti, kur grupimi i ri hipi në "vagonin" e Al Kaedës. Sigurisht, Al Kaeda dhe Shteti Islamik, nuk janë talebanë. Dhe talebanët e sotëm ndryshojnë nga organizata që strehonte Osama bin Ladenin përpara sulmeve të 11 Shtatorit. Ajo ka udhëheqje të re, nuk ka sponsorizuar terrorizmin transnacional kundër Shteteve të Bashkuara, dhe në përgjithësi sulmon objektiva ushtarake brenda Afganistanit. Por kjo s'do të thotë që Shtetet e Bashkuara, duhet të kenë ndonjë iluzion në lidhje me qëllimet e tyre përfundimtare, dhe as duhet të harrojmë se Al Kaeda është një mbështetëse besnike e talebanëve. Por thjesht nuk duket se ka ndonjë alternativë për një lloj kompromisi në Afganistan.

E njëjta logjikë mund të zbatohet edhe për grupet më të zgjedhura. Në aleancë me kauzën xhihadiste. Më së paku, duhen vlerësuar kostot dhe përfitimet potenciale të angazhimit. Në fund të fundit, një disfatë ushtarake e Shtetit Islamik në Siri dhe madje edhe në Irak, nuk do të nënkuptonte fundin e terrorizmit dhe ekstremizmit. ISIS është zotuar të vazhdojë luftën e tij, dhe ka bërë thirrje për sulme të reja në Perëndim. Dhe Al Kaeda dhe rrjeti i saj i aleatëve, do të përfitojnë nga rënia e rivalit të tyre më të shquar në Lindjen e Mesme. Ndërkohë, vazhdojnë shumica e problemeve themelore, që çuan në ngritjen e organizatave xhihadiste. Nuk ka një përgjigje të thjeshtë për t'u vënë në zbatim, përballë një kërcënimi kaq kompleks, të shtrirë dhe të paqëndrueshëm. Por vlen të merren në konsideratë të gjitha opsionet, duke përfshirë negociatat me palët e zgjedhura. (Foreign Policy)

(Martha Crenshaw, është bashkëpunëtoare në Qendrën për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Institutin Freeman Spogli, dhe profesore e shkencave politike në Universitetin e Stenfordit)

Dështimi i referendumit, një mësim i hidhur

Nga
Adelheid FEILCKE



Dështimi qartazi i referendumit në Maqedoni si rrjedhojë e një pjesëmarrjeje shumë të ulët është një mësim i hidhur për shumë palë: Për qeverinë në Shkup, për qeverinë në Athinë, për mbështetësit në BE dhe në NATO dhe për rajonin. Edhe pse referendumi jo detyruës nuk kishte ndonjë peshë të veçantë, prej tij varej diçka e madhe: bëhej fjalë për emërtimin e ri të shtetit të Ballkanit, për pajtimin me Greqinë dhe kësaj për anëtarësimin në NATO dhe në BE, shkurt pra për të ardhmen e republikës së vogël në bashkësinë e shteteve dhe të vlerave europiane dhe përëndimore.

Ende këto nuk janë humbur, por rezultati i referendumit pasqyron atmosferën në popull, gjë që të fut në mendime. Edhe pse tani shumë përpiqen ta zbkurojnë situatën, për faktin se 90 për qind e votuesve u shprehën pro, shumica e madhe në vend heshiti dhe bojkotoi në mënyrë aktive. E kësaj mungon miratimi i gjerë i shpresuar për një proces, që në referendum kishte ndërlidhur qartazi tre çështje të së ardhmes: Marrëveshja me Greqinë. Integrimi në BE dhe në NATO. Ndaj dështimi i referendumit është edhe një sinjal paralajmëruës jo vetëm për zhvillimet në vend, por edhe për orientimin e ardhshëm gjeopolitik të Ballkanit.

Pavarësisht mbështetjes masive nga politikanë të nivelit të lartë si kancelarja Merkel, presidenti i Këshillit të BE-së, Kurz, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, kryemi-

Pjesëmarrja e ulët në referendumin për emrin në Maqedoni është një pikënisje e keqe për zhvillimin e mëtejshëm të vendit

nistri Zoran Zaev dhe qeveria e tij gjatë javëve të fundit nuk ia arritën ta mobilizojnë sa duhet popullin dhe ta bindin atë për avantazhet e marrëveshjes. Mjaft emocionale dhe rigorozë është rezistenca e kundërshtarëve, të cilët donin pjesërisht të ndëshkonin qeverinë dhe pjesërisht të mos pranonin emrin Maqedonia e Veriut. Bojkoti masiv i referendumit tregon përçarjen politike të shoqërisë maqedonase dhe një pasiguri të madhe lidhur me çështjen e identitetit kombëtar dhe atij europian: Llogaria se ndjenjat kombëtare do të pakësoheshin në favor të një perspektive europiane, nuk doli. Përkundrazi: konfrontimi edhe më emocional për çështjen e emrit stilizohet si temë e kombit dhe identitetit maqedonas.

Tani po shpaguhen dekadat e humbura, gjatë të cilave brenda vendit dhe në nivel ndërkombëtar është bërë shumë pak për ta zgjidhur grindjen mes Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e Maqedonisë dhe trashëgiminë e perandorisë antike. Këmbëngulja, frika dhe plagët në Shkup janë të thella. Euforia e deritanishme për BE-në dhe NATO-n tani

po vishet prej dyshimit.

Edhe nëse frikërat prej influencës ruse nuk u vërtetuan në referendum, narrativa antiperëndimore po zgjerohet. Lufta për kokat në Maqedoni është në kulmin e saj. Pas referendumit të dështuar, kryeministri i Maqedonisë tani të gjitha shpresat i var tek e vetmja kartë që i mbetet, raundi vendimtar, kur parlamenti i Maqedonisë të votojë për marrëveshjen me Greqinë, për të cilën janë të nevojshme dy të tretat e votave të deputetëve. Të dielën në mbrëmje ai u bëri thirrje deputetëve të opozitës që ta mbështesin. Në rast të kundërt në dhjetor do të shpallen zgjedhjet e reja. Partia në opozitë VMRO DPMN triumfon pas dështimit të referendumit dhe e shpall qeverinë e Zaevit e po ashtu edhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë të dështuar. Pavarësisht përbetimit, se është gjithashtu për integrimin në BE dhe në NATO, opozita tregohet lidhur me çështjen e emrit e palëkundshme dhe pas suksesit të bojkotit të sotëm e inkurajuar.

Me luftërat në politikën e brendshme, ajo po mban peng të gjithë vendin. Ajo që duket e pamundur duhet të ndodhë tani, disa deputetë nga radhët e opozitës duhet të ndryshojnë mendjen për arritjen e shumicës së nevojshme të dy të tretave. Në rast të kundërt marrëveshja me Greqinë është e dështuar, anëtarësimi në NATO dhe në BE do të jetë sërish i largët. Pasojat për Maqedoninë do të ishin fatale. E ardhmja e vendit sërish do të jetë më shumë se e pasigurt.

(DW)



ORGANIZATA HUMANITARE "EL HILAL"
ХУМАНИТАРНА ОРГАНИЗАЦИЈА „ЕЛ ХИЛАЛ“,
HUMANITARIAN ORGANIZATION "EL HILAL"
"EL HILAL" YARDIMLAŞMA TEŞKİLATI

Address: Str. 106; No.64/2-1000-Skopje; Macedonia; Tel/fax: **389(0)23215338 E-mail: info@elhilal.org

SHPALL: KONKURS

për bursa studentore për vitin akademik 2018/19

Kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët për këtë konkurs janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë student i Universitete shtetërore në Maqedoni (rastet specifike do të trajtohen posaçërisht);
- Përparësi do të kenë studentët nga familjet ekonomikisht të rrezikuara, jetimët dhe studentët e viteve më të larta akademike;
- Në ndarjen e bursave do të përfshihen studentët nga tërë territori i vendit në bashkëpunim me Degët e "El Hilal"-it.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Certifikatë e lindjes (fotokopje);
- Vërtetim se është student i rregullt në vitin 2018/19;
- Biografi e shkurtër për gjendjen ekonomike;
- Kopje të indeksit me nota nga të gjitha vitet dhe kopjen e faqes me fotografinë;
- Një fotografi;
- Formular i plotësuar (të shkarkohet nga web faqja ose të merret nga zyrat e "El Hilal"-it);
- Studentët jetimë duhet të dorëzojnë certifikatën e vdekjes së prindit;
- Studentët që to të fitojnë bursën do të nënshkruajnë kontratë me OH "El Hilal".

Bursa studentore ndahet vetëm për vitin akademik 2018-2019.

Të interesuarit dokumentet mund t'i dorëzojnë në selinë e OH "El Hilal" prej: 03.10.2018 – 17.10.2018 çdo ditë pune (përveç të shtunën e të dielën) prej orës 10:00-16:00 në këtë adresë: Rr. 106 (Çarshija e Vjetër) nr. 64/2, Shkup.

Kandidatët dokumentet mund t'i dorëzojnë edhe nëpër Degët e OH "El Hilal" në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë deri në afatin e caktuar.

Dokumentet e pakompletuara dhe jashtë afatit të konkursit nuk do të merren parasysh.

OH "EL HILAL"

Web: www.elhilal.org dhe në Facebook: <https://www.facebook.com/www.elhilal.net>

Në bazë të nenit 82 alinesë 2 të Ligjit për Pyjet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2009, 24/2011, 53/2011, 25/2013, 79/2013, 147/2013, 43/2014, 160/2014, 33/2015, 44/2015, 147/2015, 7/2016 dhe 39/2016) dhe Udhëzuesit për Sistematizim të Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Furnizimit me Ujëra nr. 04-6397/1 të datës 01.06.2016, ndryshimet në Udhëzuesin nr. 04-11933/2 të datës 01.12.2015, nr.04-11314/3 të datës 08.12.2015, nr.04-2753/2 të datës 20.02.2016, nr.04-5362/2 të datës 13.06.2016, nr.04-6948/1 të datës 11.07.2016, nr.04-8800/3 të datës 29.09.2016, nr.04-10445/1 të datës 01.12.2016, nr.04-994/1 të datës 01.02.2017, nr.04-2947/1 të datës 11.04.2017, nr.04-5497/1 të datës 31.07.2017, nr.04-2591/1 të datës 03.02.2018, nr.04-5444/1 të datës 26.04.2018, nr.04-6112/1 të datës 17.05.2018 dhe 04-8025/3 të datës 03.08.2018, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Furnizimit me Ujëra shpallë:

KONKURS nr. 01/2018

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Furnizimit me Ujëra shpallë konkurs për kohë të pacaktuar për 1 (një) person zyrtar të autorizuar në Sektorin për Polici Pyjore në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Polici Pyjore.

Kushte të përgjithshme

-të jetë qytetar i Republikës së Maqedonisë, të jetë përdorues aktiv i gjuhës maqedonase, të jetë i moshës madhore, të jetë fizikisht dhe psikikisht i aftë për kryerjen e punëve të Policisë Pyjore, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë dhënë ndalesë për kryerjen e profesionit, fushës apo detyrës.

Kushte të veçanta

-të posedojë nivelin e kualifikimit VI A sipas Kornizës Kombëtare për Kualifikimet e Shkollimit të Lartë dhe të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallët e VII/1 të mbaruar të arsimit, të ketë së paku pesë vjet përvojë pune, të njej programe kompjuterike për punë në zyrë, të jetë i përshtatshëm për vendin e punës, gjë që dëshmohet me vërtetim për test të kaluar psikologjik dhe test për integritet, të jetë i denjë për armëmbajtje në pajtueshmëri me rregullat për pronësi dhe mbajtje të armëve.

Detyra të punës

-Organizim, kahëzim, koordinim të punës së njësiteve dhe stacioneve të policisë pyjore dhe kryerjen e detyrave më të ndërlikuara të punës në sektor, kryerje të kontrollit dhe mbikëqyrjes së punëve në sektor, ndarje të punëve dhe detyrave të të punësuarve në sektor dhe komandantëve të stacioneve të policisë pyjore. Përgatitje të raportit për punë në sektor dhe njësite, marrje të iniciativave për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve të veçanta të rrethit të sektorit, bashkëpunim me udhëheqësit e sektorëve tjerë në Ministri apo organet tjera.

Dërgesa e dokumentacionit

-Paraqitje e mbushur siç duhet, e cila mund të merret nga Sektori për Polici Pyjore, vërtetim për nënshetësi (origjinal ose kopje e noterizuar), vërtetim mjekësor nga mjekësia e punës (në origjinal), vërtetim që nuk ka ndalesë për kryerje të profesionit, fushës dhe detyrës (nga Regjistri Qendror, në origjinal), diplomë për shkollimin e kryer (origjinal ose kopje e noterizuar), certifikatë për njohjen e programeve kompjuterike (origjinal ose kopje e noterizuar), vërtetim për dhënien e testit psikologjik (origjinal ose kopje e noterizuar), vërtetim për dhënien e testit për integritet (origjinal ose kopje e noterizuar), vërtetim për aftësi për armëmbajtje, biografi e shkurtër.

VËREJTJE: Kushtet e dhëna në konkurs kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes.

Paraqitja për punësim duhet të dorëzohet në afat prej 15 ditësh nga momenti i publikimit të konkursit në ueb faqen e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari, dhe Furnizim me Ujë me titull "Deri të Sektorit për Polici Pyjore MOS E HAP PËR PUNËSIM NË BAZË TË KONKURSIT NUMËR 01/2018 rr. Aminta Treti numër 2 Shkup"

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në pajtim me Ligjin për Pyje, Ligjin për të Punësuarit e Sektorit Publik dhe Ligjit për Marrëdhënie të Punës.

Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni i formuar me vendim të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Furnizim me Ujë.

Provimi do të përbëhet prej 40 pyetjeve nga gjithsej 350 pyetje të publikuara në ueb faqen e Ministrisë, me maksimum 60 pikë.

Intervista sjellë 40 pikë dhe do të bëhet nga ana e komisionit me kandidatët që kanë fituar minimum 51% të numrit të përgjithshëm të pikëve të provimit.

Orari i punës

-Ditë pune: e hënë - e premtë

-Orë pune brenda javës – 40 orë

Shuma neto e pagës: 27,206,00 denarë

VËREJTJE: Punësime të parapara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: 1 Maqedonas(e).



UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"
FAKULTETI FILOLOGJIK "BLAZHE KONESKI" - SHKUP
Bul. Krste Mirovski pa 1000 Shkup, R. Maqedonisë
Dekanat: +389 2 3240 401, Qendra: +389 2 3240 400
Faks: +389 2 3223-811



Nr. _____
Shkup

Në bazë të nenit 172, nenit 175 dhe nenit 168 paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82 e 8 maj 2018), nenit 48 paragrafi 1 pika 25 e Rregullores për marrëdhënie e brendshme dhe punës së Fakultetit filologjik "Blazhe Koneski" në Shkup në përberje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe nenit 34 paragrafi 1 nga Rregulloja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe titujt bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, të publikuar në Fletën universitare nr. 274 (Teksti i pasruar), Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit filologjik "Blazhe Koneski" në Shkup në përberje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS
Për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor

- Një lektor të gjuhës gjermane.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme me Ligjin për arsim të lartë të RM dhe Rregulloren për kriteret e vetme dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Fletëparaqitjet, shtojcat (biografi, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, realizime pedagogjike dhe të tjera nga fillimi i karrierës e deri në ditën e paraqitjes), dëshmitë së kandidatët kanë arritur shkallën e caktuar shkencore magjistër të sferës shkencore për të cilën zgjidhen, dërgohen në 4 (katër) kopje në Arkivin e Fakultetit filologjik "Blazhe Koneski" në Shkup, në afat prej 8 ditëve nga publikimi i Konkursit.

Përveç asaj kandidatët duhet të dorëzojnë edhe nga një kopje të punimeve shkencore dhe profesionale.

Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Orari i punës do të jetë në ndërrim të parë, prej ora 8 deri në ora 16, ndërsa neto pagesa fillestare për një lektor do të jetë 26.639,00 denarë.

Fillimi, përfundimi dhe orari i punës dhe shumën në të holla e pagesës bazë për mësimdhënësin janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin zgjidhet mësimdhënësi.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh për shqyrtim.

DEKAN
i Fakultetit filologjik
Prof. Dr. Aneta Ducevska

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" – SHKUP
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE
SHKUP

REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITY "Ss. KYRIL AND METHODIUS" SKOPJE
FACULTY OF VETERINARY MEDICINE
SKOPJE

Numër 03-1645
2.10.2018
Në bazë të Vendimit të Drejtorisë së dekanatit nr. 0201- 1566/4-15 të datës 18.09.2018, Fakulteti i mjekësisë veterinare në Shkup publikon

SHITJE TË AUTOMJETIT PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Fakulteti i mjekësisë veterinare në Shkup, me seli në rr. "Lazar Pop Trajkov" nr. 5-7 bën shityn e një automjeti përmes ankandit publik:
 - Marka CITROEN JUMPER, me tabela të regjistrimit SK – 618-MB, viti i prodhimit 2003, numri i shasisë ZFA25000001596868, numri i motorit F1AE0481D0931833, fuqia e motorit 93,5 KW, vende për tu ultur 3, ngjyra e bardhë, illoji i karburantit – dizel.
Cmimi fillestar i automjetit është: 125.767,50 denarë.
 - 2. Në çmimin e shitjes është përfshirë edhe TVSH dhe e njëjta është në barë të blerësit. Shpenzimet për autorizim të makinës në noter si dhe shpenzimet tjera të paparashikueshme bien në barrë të blerësit.
 - 3. Të drejtë në ankand kanë të gjithë subjektet juridike dhe fizike të cilët do të parashtrojnë garanci në dorë, në shumë prej 20% të çmimit fillestar të makinës, një ditë para mbajtjes së ankandit publik. Depozita e paguar në të holla nga ofertuesi më i volitshëm llogaritet në çmimin e përllogarit, ndërsa ofertuesve të tjerë garancia e paguar do t'u kthehet.
 - 4. Nëse blerësi në afatin e theksuar nuk paguan shumën e licitacionit, garancia e paguar nuk do t'i kthehet.
 - 5. Automjeti lëndë e shitjes mund të shihet çdo ditë pune prej ora 9-12 në Fakultetin e mjekësisë veterinare-Instituti për riprodhim dhe biomedicinë.
 - 6. Të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik janë të obliguar që me vete të parashtrojnë dokument identifikimi, gjegjësisht autorizim të vërtetuar në noter (nëse personi përfaqëson firmë ose merret vesh me ndonjë subjekt tjetër fizik).
 - 7. Ankandi publik do të mbahet më datë 15.10.2018 (e hënë) në lokalet e Fakultetit me fillim në ora 10.00. Shtija do të bëhet sipas parimit e parë – e blerë, ndërsa pas shitjes së automjetit Fakulteti nuk ndërmerr përgjegjësi për mungesat materiale të së njëjtës.
 - 8. Pas shitjes së realizuar lidhet marrëveshje për shitblerje mes Fakultetit dhe ofertuesit të zgjedhur.
 - 9. Blerësi është i obliguar që menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes shumën e përcaktuar në licitacion ta paguajë në xhillologarinë 1600104561 788 15, shifra e të hyrave: 725939 41 dhe me fletëpagesë ta marrë automjetin e blerë më së voni në afat prej pesë ditëve nga dita e pagesës.

Nga Komisioni për shityn



“Qyteti fantazmë” shkaku i aeroportit

Ishte zhurma e padurueshme e aeroplanëve gjigantë ajo e cila bëri që pothuajse të gjithë banorët e këtij fshati francez të zhvendosen. I quajtur si ‘qyteti fantazmë’, shumica e shtëpive tani janë të braktisura, grafitet mbulojnë muret e vegjetacioni është duke mbuluar rrënojat.

Cjithçka filloi në vitin 1970 me ndërtimin e aeroportit parisien “Charles de Gaulle”, atëkohë më i madhi në Evropë. Pista e parë mbulonte fshatin Gosanvilë Vju Pe, ndryshe fshat tipik francez viktimë e modernizimit. Aeroporti i Parisit ishte detyruar të blinte shtëpitë e atyre të cilët deshën të largoheshin dhe popullata kishte rënë nga 1 mijë njerëz në vetëm 300. Por një burrë ende shpreson të sjellë pak jetë në këtë vend. 68-vjeçari Filip Vilard ishte njëri prej atyre që deshën të rrinin, pavarësisht zhurmës së vazhdueshme mbi kokën e tij. Që nga ajo kohë ai po lufton me largimet nga fshati dhe do që njerëzit të kthehen. “Që nga viti 1973 kemi kërkuar që shtëpitë të mos prishën, në mënyrë që të mund të përdorim sërish këto shtëpi”, tha ai. Vilard tha se përgjatë 40 vjetësh shumë ide ishin vënë në tavolinë që njerëzit të tërhiqeshin prapa. Disa projekte për të shpëtuar qytetin iu referoheshin librarive, punëtorive apo edhe ide më kundërthënëse sikurse vendosja e banorëve me probleme me dëgjim në këtë fshat. Sot me 350 banorë, rritje e vogël ndryshe, banorët janë mësuar të jetojnë me zhurmën. Veronique është një prej tyre. Ajo u lind në këtë fshat dhe është e lumtur me jetën këtu. Dhe me presionin sa iu përket shtëpive në Paris, Vilard shpreson që beteja e tij s’do të jetë e kot dhe ‘fantazmat’ do të largohen.



Qeveria Haradinaj nuk ka forcë për të vazhduar mandatin

Gjatë së hënës është raportuar se ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri ka ofruar dorëheqjen te kryeministri Ramush Haradinaj dhe te kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës Kadri Veseli. Tahiri thuhet se nuk është i kënaqur me zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë, si dhe me ndërhyrjet politike në këtë sektor, por jozyrtarisht mësohet se arsyeja e dorëhe-

qjes është vizita e tij e fundit në Lijenin e Ujmanit të shtunën e kaluar bashkë me presidentin Hashim Thaçi, si dhe me ministrin e Financave Bedri Hamzën, shkruan "Zëri". Njohësit e çështjeve politike konsiderojnë që dorëheqja e ministrave të qeverisë "Haradinaj" po ndodh si pasojë e moskoordinimit të koalicionit qeverisës. Madje sipas tyre nëse kjo situatë vazhdon

ditët e qeverisë "Haradinaj" janë të numëruara.

Artan Murati, nga KDI-ja, ka thënë që qeveria "Haradinaj" nuk ka forcë për të vazhduar më tutje. Murati ka thënë se koalicioni qeverisës nuk i ka numrat për të kaluar asnjë ligj.

"Qeveria 'Haradinaj' nuk ka as kontinuitet e as forcë për të çuar më tutje mandatin e vet deri në

fund dhe për këtë gjë pajtohem të gjithë, mirëpo edhe për ta rrezuar Qeverinë duhet nënshkrime në Kuvend, të cilat as opozita nuk i ka, kështu që duhet të pritët ndonjë plasaritje mes koalicionit qeverisës, ose ndonjëra prej partive në koalicion që do të dalë në krahun e opozitës dhe ta rrezojë Qeverinë", ka thënë Murati për "Zërin".



Sipas Muratit, Qeveria nuk i ka numrat as për të kaluar ligjet më të thjeshta në Kuvend.

SYNIMET PËR TREGUN E PËRBASHKËT

HAPAT QË BALLKANI PERËNDIMOR DUHET T'I NDËRMERR

Sekretariati Europian i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), përmes një artikulli të fundit, bëri të ditur se në axhendën e vitit të ardhshëm, janë parashikuar ndryshime për synimet që vendet e Ballkanit duhet të përmbushin për arritjen e një tregu të përbashkët rajonal në shumë drejtime. Sipas RCC, tre janë hapat kryesorë që u jepen shteteve të Ballkanit Perëndimor si 'detyra shtëpie' për vitin e ardhshëm, heqja e roaming në telekomunikacion, njehsimi profesional akademik, si dhe një projektim i planit të mirëfillt të investimeve. Përmes artikullit të publikuar së fundmi nga RCC, theksohet se takimi i radhës në 2019 në Poloni, do të sjellë një rifreskim të synimeve të parashikuara nga MAP REA, me qëllime më specifike. Sipas rishikimeve, rajoni duhet të vazhdojë drejt reduktimit të tarifave të roamingut në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe marrëveshjen e re / për të rishikuar roaming rajonale; të zhvillojë negociatat të plota për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale dhe të nënshkruajë marrëveshjen për të, si dhe bien dakord mbi modelin për njohjen e kualifikimeve akademike; si dhe të iniciojë zbatimin e reformave të investimeve në përputhje me RIRA, me aktivitetet e para të planifikuara të investimeve të realizuara (përfshirë turizmin).

Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor miratuan vitin e shkuar planin shumëvjeçar të veprimit për një zonë ekonomike rajonale në Ballkanin Perëndimor Gjashtë (MAP), në samitin e procesit të Berlinit të mbajtur në Trieste



Ekspertët theksojnë megjithatë se, në vitin e dytë të zbatimit të MAP REA janë arritur disa rezultate të prekshme: dinamika e rforcimit të tregtisë brendarajonale, përkatësisht protokoll shtesë mbi lehtësimin e tregtisë, është vendosur së bashku me marrëveshjen për fillimin e negociatave për përmirësimin e mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare; Axhenda Rajonale për Reformën e Investimeve (RIRA) u miratua, duke përcaktuar prioritetet e përbashkëta për zhvillimin e tregjeve të kapitalave dhe avancimet kryesore në

specializimin e mençur; Axhenda dixhitale u lançua; vijoi procesi që synon reduktimin e roamingut brenda rajonit dhe BE dhe është iniciuar forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të sigurisë kibernetike; është arritur marrëveshja për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Njohjes së Ndërsjellë mbi kualifikimet profesionale dhe synohen të miratohen Parimet për njohjen e kualifikimeve akademike.

Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor miratuan vitin e shkuar planin shumëvjeçar të veprimit për një

zonë ekonomike rajonale në Ballkanin Perëndimor Gjashtë (MAP), në samitin e procesit të Berlinit të mbajtur në Trieste. MAP, zhvillimi i të cilit u koordinua nga RCC me kërkesë të Udhëheqësve të BB dhe mbështetur nga Komisioni Europian (KE), synon të mundësojë lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe fuqisë punëtore me kualifikim të lartë; duke bërë rajonin më tërheqës për investime dhe tregti; duke përshpejtuar konvergencën me BE-në, duke sjellë kështu prosperitet për qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

Vuçiqi në Moskë, arsyet e vizitës

Vizita e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, lajm kryesor në mediat ruse.

Të gjitha mediat kryesore në Rusi kanë publikuar lajmin për vizitën e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe takimin e tij të paralajmëruar me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin.

Po ashtu, ato kanë sqaruar se tensionet e fundit në Ballkan janë arsyeja kryesore e vizitës së Vuçiqit në Moskë.

Raportimin e tyre e kanë plotësuar me detaje të vizitës së fundit të Vuçiqit në Kosovë.

Vuçiq mbrëmë ka deklaruar se në Moskë do të kërkojë mbështetje konkrete politike për Serbinë.

"Besoj se nga Putin do ta marrim atë mbështetje, njësoj siç e kishim gjithmonë nga Rusia në periudhën paraprake", deklaroi ai.



VLERËSIMI I MËSIMDHËNËSVE NË KOSOVË

Të pasuksesshmit mund ta humbin licensën

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nisur zyrtarisht procesin e vlerësimit të mësimdhënësve. Ministri Shyqyri Bytyqi tha se ky proces është në kuadër të nismës për rritjen e cilësisë në arsim.

"Pasi që jemi zotuar si ministri janë bërë të gjitha përgatitjet dhe është bërë përzgjedhja e parë e mësimdhënësve për matjen e performancës. Qëllimi i matjes është që të ngritet cilësia në arsim

Të gjithë mësimdhënësit do duhet të kenë përgatitje të lartë në lëndët e tyre", tha Bytyqi, transmeton Kallxo.com.

Sipas Bytyqit nga vlerësimet mund të dalin katër lloj rezultate: i shkëlqyeshëm, i mirë, i kënaqshëm dhe i pakënaqshëm.

Sipas tij një rezultat i keq mund të ndikojë në humbjen e licensës për mësimdhënësin.

"Duke qenë se jemi në fazën fillestare janë zgjedhur shkollat e

para. 217 mësimdhënës të parë që do t'i nënshtrohen fazën e parë të matjes së performancës. Matja e performancës së brendshme dhe jashtme. Mund të ketë mësimdhënës që mund të dështojë në rilicensim", tha ai.

Në anën tjetër, Kryeinspektori i Arsimit, Dëfrim Gashi tregoi fazat e vlerësimit që sipas tij përfshijnë vlerësimin vetanak të mësimdhënësit, pastaj të drejtorit të shkollës dhe në fund inspektoratit.



Ministri ritheksoi se ky lloj vlerësimi do duhej të përkrahej edhe nga mësuesit pasi sipas tij i ofron mundësi për ngritje në karrierë. Në këto vlerësime, më-

simdhënësit kanë të drejtë ankese dhe në rast të humbjes së licensës, kanë të drejtë riaplikimi.

Faza e parë e vlerësimit pritet të përmbyllet në vitin 2021.

ZVICRA KËRKON PUNËTORË DUKE I PAJISUR ME LEJE

Vitin e ardhshëm do të lëshohen 4.500 leje qëndrimi, plus 4.000 leje B me një kohëzgjatje pesëvjeçare. Numri i lejeve të qëndrimit afatshkurtër L, me kohëzgjatje prej tre deri në 12 muaj, do të shkurtohet me 500

Ndërkohë që për pak ditë hapen aplikimet për lotarinë amerikane, një lajm i mirë vjen nga Zvicra, e cila ka marrë vendimin që të japë 1 mijë leje shtesë për punëtorët që vijnë nga jashtë vendeve të BE-së. Ky vendim i autoriteteve zvicerane vjen si përgjigje pas kërkesave të kompanive dhe kantoneve për punësimin e punëtorëve të kualifikuar.

Kështu që nga viti i ardhshëm 1000 punëtorë nga shtetet që s'janë pjesë e BE-së do të lejohen të punojnë në Zvicër.

Duke nisur nga 2019, firmat do të jenë në gjendje të rekrutojnë 8,500 punëtorë të huaj nga vende të tilla si Shtetet e Bashkuara, Kina dhe India.

Ndërkohë, lejet shtesë prej 1,000 do t'u japin firmave, në të njëjtin numër të punëtorëve që nuk janë në BE, si më 2014, bën të ditur "Swissinfo.ch".



Ky ishte viti kur te votuesit zviceranë kaloi një iniciativë duke bërë thirrje qeverisë për të kufizuar migracionin.

Si përgjigje, autoritetet ulën numrin e lejeve të punës së "vendit të tretë" në 6.500. Firmat zvicerane tani janë gjithashtu të detyruara të provojnë se nuk ka punëtorë zviceranë në dispozicion për të mbushur pozicionet para se të punësojë një kandidat të huaj, shkruan

albinfo.ch. Vitin e kaluar, Zürich, Gjenevë dhe Basel, tre kantone që tradicionalisht kanë një fuqi punëtorë të madhe të huaj, bashkuan forcat për të nxitur qeverinë që të rrisë nivelet e lejeve.

Udhëheqësit kantonalë argumentuan se mirëqenia ekonomike dhe reputacioni i Zvicrës si një qendër globale për biznes dhe humlumtim u dëmtua nga kufizimet. Protestat e tyre duket se janë

dëgjuar.

Vitin e ardhshëm do të lëshohen 4.500 leje qëndrimi, plus 4.000 leje B me një kohëzgjatje pesëvjeçare. Numri i lejeve të qëndrimit afatshkurtër L, me kohëzgjatje prej tre deri në 12 muaj, do të shkurtohet me 500.

Qeveria do të mbajë në shtesë rezerva prej 1,000 lejeve B dhe do t'i dorëzojë ato në kantone sipas kërkesës.



Turqia i kërkon Gjermanisë ekstradimin e 136 personave

"Turqia u ka dorëzuar autoriteteve gjermane një listë prej 136 personash, që dëshiron të ekstradojë me akuzat për lidhje të dyshuara me grupet terroriste", ka thënë presidenti Erdogan për gazetën Hurriyet. Presidenti turk vizitoi në fundjavë Berlinin, në një tentativë për të rivendosur normalitetin e marrëdhënieve gjermano-turke, të dëmtuara pas arrestimit të disa shtetasve gjermanë, me akuzën për përfshirje në grushtin e shtetit të vitit 2016.

"Nuk i di të gjitha emrat, por është një listë thelbësore. Një listë prej 136 personash në Gjermani, për të cilët ne kemi kërkuar zyrtarisht ekstradimin", deklaroi Erdogan për gazetën turke.

Ai nuk ka specifikuar se cilat grupe janë përfshirë, ka thënë se Gjermania duhet të jenë më efektive në kundërvënien ndaj anëtarëve të rrjetit të klerikut me bazë në SHBA, Fethullah Gulen, Partisë së jashtëligjshme të Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) dhe grupit militant majtist DHKP-C.

Nga ana tjetër, media me bazë në Gjermani, Deutsche Welle Turkey, citoi zyrtarët e qeverisë gjermane, të cilët thanë se Erdogan nuk ka dorëzuar asnjë listë zyrtare, për ekstradim të shtetasve turq në Ankara.

Britania: Mund të dalim nga BE-ja edhe pa marrëveshje



Britania mund të dalë nga BE-ja pa një marrëveshje me Bashkimin Europian. Sipas ministrit britanik për "Brexit" Dominic Raab, kërkesat e BE-së janë të ekzagjeruara.

"Gatishmëria jonë për kompromis nuk është e pakufishme. Ne nuk do të kërkojmë shtyrjen e zbatimit të nenit 50-të.

Nëse oferta e vetme e BE e

kërcënon unionin tonë, atëherë nuk na mbetet rrugë tjetër, veçse të dalim pa marrëveshje", theksoi Raab.

Sipas Raabe, BE kërkon ta mbajë vendin në union përmes trukeve. Edhe ministri britanik i Tregtisë paralajmëroi Bashkimin Europian. "Mungesa e marrëveshjes do të dëmtojë shumë edhe tregtinë e BE-së", tha ai.

Shpresojmë t'i zgjidhim problemet me SHBA-në sa më shpejt

Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan tha se vendi i tij shpreson të përmirësojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, pas tensioneve që ka shkaktuar burgosja e një pastori amerikan.

"Me vullnetin e Zotit, shpresojmë t'i zgjidhim problemet me Amerikën brenda një kohe të shkurtër dhe t'i rishillojmë marrëdhëniet në fushat politike dhe ekonomike, me frymën e partneritetit strategjik", tha Erdogan në një fjalim para Parlamentit turk.

Mosmarrëveshja midis dy vendeve ka të bëjë me pastorin

Andreë Brunson, i cili është arrestuar nga autoritetet turke në vitin 2016, nën akuzat për terrorizëm. Mosmarrëveshja ka shkaktuar edhe rënie të lirës turke.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka dyfishuar tarifën mbi importin e aluminit dhe çelikut turk, për shkak të mbajtjes së Brunsonit në paraburgim dhe Ankaraja është përgjigjur në të njëjtën mënyrë.

"Jemi të vendosur të luftojmë brenda kufijve të diplomacisë dhe ligjit, kundër kësaj qasjeje të shtrembëruar, që imponon sanksione mbi vendin tonë, duke përdorur

si pretekst një prift, i cili është në gjyq për marrëdhëniet e tij të mjegullta me grupet terroriste", tha Erdogan.

Ai tha se Uashingtoni "po përpiqet t'i zgjidhë problemet politike dhe ligjore përmes kërcënimeve e shantazhit dhe jo dialogut".

"Kjo në fakt, do t'ia shkaktojë dëmin më të madh SHBA-së, në afat të mesëm dhe të gjatë", tha Erdogan. Për shkak të Brunsonit, SHBA i ka vënë sanksione ministrit turk të Drejtësisë, Abdulhamit Gul dhe ministrit të Brendshëm Suleyman Soylu.



Situata në Levantin arab dhe sidomos në zonën e Mashriqit, zonë që qysh nga koha e Portës së Lartë, tregonte rajonet aktuale të Izraelit, Palestinës, Sirisë, Libanit, Jordanisë, jugut të Turqisë, është e karakterizuar në këto javë të fundit nga një fermentim i konsiderueshëm. Një luftë, ajo siriane, që me sa duket po mbaron, por vatra të tjera po fillojnë të ndizen në të katër anët e rajonit. Në mënyrë të veçantë Lartësitë Golan duket se janë zona ku Izraeli dhe Irani mund të vendosin të rregullojnë çështje të hapura prej dekadash

LUFTA PËR KONTROLLIN E KODRAVE GOLAN



Një seri faktesh, në mënyrë të habitshme të përqendruara gjatë javëve të fundit tregojnë një dinamicitet të caktuar që karakterizon të gjithë aktorët e rajonit. Shtetet e Bashkuara, Izraeli, Irani dhe Rusia, drejtpërsëdrejti nëpërmjet deklaratash zyrtare ose nëpërmjet aleatëve rajonalë, po lëvizin gurë në skakierë. Qendra nevralgjike e një dinamiciteti të tillë përfaqësohet nga Lartësitë Golan, zona malore kufitare në kufirin midis Izraelit dhe Sirisë e pushtuar nga IDF-ja (Forca Mbrojtëse e Izraelit, shënimi im.) nga viti 1967 dhe e çmilitarizuar me Marrëveshjen për Çimpenjimin me ushtrinë siriane, e garantuar nga Kombet e Bashkuara dhe që i përket vitit 1974. Le të provojmë të vëmë në sekuençë disa prej këtyre fakteve dhe të mund t'u parashikojmë zhvillimet e mundshme.

EVAKUIMI I HELMETAVE TË BARDHA

Në natën midis 22 dhe 23 korrikut 2018, në Lartësitë Golan është zhvilluar një operacion spektakolar evakuimi i 442 helmetave të bardha, organizatë humanitare, për më tepër e diskutuar, që prej vitesh merret me asistimin e civilëve në zonat nën kontrollin e opozitës ndaj regjimit të Damaskut.

Qeveria siriane denoncon se operacioni, sipas regjimit e financuar nga Shtetet e Bashkuara dhe nga George Soros, në realitet përfaqëson një operacion kolosal të CIA-s për të mbështetur rebelët dhe terroristët islamikë. Efektivisht, prej vitesh helmetat e bardha, nëpërmjet një përdorimi të zgjuar të mediave sociale, denoncojnë

shkeljen e të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës e kryera nga forcat e Bashar al Assad: bombardime të pakontrolluara, tortura, vrasje dhe përdorim armësh kimike, përfshi sulmin e diskutuar me klor dhe me gaz nervor në Chouta lindore të Douma në prillin e këtij viti.

442 të evakuuarit (në fillim ishte folur për 800), vinin nga zona e Daraa, ku trupat qeveritare siriane të mbështetura nga rusët dhe nga Hizballahu, po luftojnë një prej betejave të fundit vendimtare për ripushtimin e një prej pjesëve të pakta të territorit sirian akoma në duart e rebelëve. Njerëzit që i përkisnin organizatës humanitare dhe familjet e tyre kanë mundur të hyjnë në Jordani drejtpërsëdrejti nga zona e Daraa, megjithatë duke u bërë fjalë për një zonë të kontrolluar nga Hezbollahu e nga

trupa qeveritare siriane dhe, duke ia pasur frikën raprezaljeve, kanë siguruar hyrjen në Izrael nëpërmjet Qafës së Kuneitra, nëpërmjet rripit të sigurisë mbi Lartësitë Golan. Duke i prituar kanë qenë ushtria izraelite dhe mediat. Operatorë humanitarë dhe familje janë marrë në dorëzim dhe janë shoqëruar deri në kufirin me Jordaninë. Nga Jordania të evakuuarit do të marrin rrugën e Gjermanisë e të Kanadasë.

Natyrisht që operacioni i Izraelit ka pasur miratimin amerikan dhe ka përfaqësuar një skup të mirë publicitar për shtetin hebraik. Në të njëjtën mënyrë nuk është i qartë roli i luajtur nga Rusia. Burimet ruse e kanë hedhur poshtë faktin se ka pasur miratim të Moskës për evakuimin, megjithatë duket e vështirë që një operacioni

tillë të ketë ndodhur pa konsensusin rus.

SULM IZRAELIT MBI MASYAF

Më 22 korrik, pak orë përpara operacionit të evakuimit nëpërmjet Lartësive Golan, aviacioni izraelit ka bombarduar një pikë siriane në qytetin Masyaf në krahinën Hama. Bëhet fjalë për të njëjtën pikë të goditur tashmë në shtatorin e 2017, ku inteligjenca izraelite thekson se prodhohen armë kimike. Operacioni duket se ka pasur një zhvillim të mëtejshëm më 5 gusht, atëherë kur një bombë ka vrarë gjithmonë në Hama Gjeneralin Aziz Asbar, shkencëtar sirian në krye të qendrës kërkimore të Masyaf, pse jo - sipas burimeve të afërta me opozitën siriane - e një program për zhvillimin e prodhimit të raketave tokë - tokë



me rreze të shkurtër në bashkëpunim me Iranin. Roli i shkencëtarit dhe atribumi i vdekjes së tij një operacioni izraelit natyrisht që është i gjithi për t'u verifikuar.

VIZITA E LAVROV NË IZRAEL

Gjithmonë të njëjtat orë (më 23 korrik), befasisht Ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Valeri Guerassimov, ka shkuar për vizitë në Jerusalem për t'u takuar me Binyamin Netanyahu, edhe ky i shoqëruar nga Ministri i Mbrojtjes Avigdor Lieberman.

Nga noftimet e pakta për takimin, është e hipotezueshme se Netanyahu dhe Lavrov kanë diskutuar për situatën që po përvijohet në kufirin midis Sirisë dhe Izraelit, domethënë për zonën në Lartësitë Golan. Ajo që e preokupon Izraelin nuk është edhe aq rikthimi i trupave të al Assad në zonë sesa prania e Hezbollahut libanes dhe e kuartëve të Forcës Quds, trupat speciale e Gardianëve të Revolucionit të pranishme në Siri dhe nën komandën e Gjeneralit Qasem Soleimani.

Lavrov duket se i ka premtuar Netanyahu 100 kilometra zonë kushinetë brenda së cilës milicite e Hezbollahut nuk duhet të penetrojnë. Vlen të kujtohet se Lartësitë Golan janë nën kontrollin izraelit nga lufta e vitit 1967, posedim i theksuar më tej nga përfundimi fitimtar i Luftës së Yom Kippur (1973). Nga viti 1974, nëpërmjet reparteve të UNDOF-it (United Nations Disengagement Observer Force), Kombet e Bashkuara garantojnë në Lartësitë Golan kontrollin e një rripi sigurie të çmilitarizuar, ku as izraelitët, as sirianët nuk mund të penetrojnë. Premtimi i Lavrov do të sillte 100 kilometra të mëtejshme sigurie, por në Izrael ka skepticizëm.

PATRULLA RUSE NË LARTËSITË GOLAN

Premtimet mënjane, Rusia është e vendosur që ta luajë deri në fund lojën e saj në Siri. Rusia e këtyre orëve të fundit përfaqësohet nga prania e 8 patrullave të formuara nga ushtarë çeçen të inkuadruar midis trupave ruse që Moskë ka vënë për patrullimin e Lartësive. Patrullat çeçene u shohën atyre të Kombeve të Bashkuara pa qenë parashikuar/ndarë kurrfarë integrimi. Rrethana është kurioze dhe nuk është e qartë nëse një risi e tillë është frut i bisedimeve midis Netanyahu dhe Lavrov apo nëse bëhet fjalë për një iniciativë ruse të prirur që të rishënojë rolin e rinovuar në rajon.

Helmetat blu të UNDOF-it kanë mundur gjithsesi të kryejnë, pas 6 vitesh të mira, patrullimin e parë në zonën e vijës së çimpenjimit midis Sirisë dhe Izraelit të shoqëruar nga policia ushtarake ruse. Ai që e ka referuar ka qenë Gjenerali Sergej Rudskoy, Shefi i Komandës Operative të Shtabit të

Përgjithshëm rus, sipas oficerit të lartë, forcat siriane kanë rimarrë kontrollin e plotë të zonës, duke krijuar kushtet për rifillimin e misionit të Kombeve të Bashkuara edhe mbi anën siriane të Lartësive Golan. Misioni ishte ndërprerë pasi rebelët sirianët kishin kidnapuar 21 helmeta blu në 2011, duke i lëshuar pas 4 ditësh.

Përtej propagandës së Moskës dhe vullnetit për t'ju treguar botës si agjentë të rivendosjes së ligjshmërisë ndërkombëtare, cili është përfitimi për Moskën që të vihet në mes midis Izraelit dhe milicive shiite? Dhe sidomos a ka për të fituar apo Izraeli që e vë sigurinë e vet në duart e rusëve?

RREZIKU I NJË INCIDENTI

Në të njëjtat orë kur zhvilloheshin bisedimet Netanyahu - Lavrov, sistemi mobil i mbrojtjes antiraketore izraelite "David's Sling" vihej në veprim për të provuar që të interceptonte dy raketa ruse SS 21, të qëlluara nga Siria në drejtim të Lartësive Golan. Të dyja kanë rënë më pas në territorin sirian. Nuk është e qartë se cili ishte objektivi i raketave të tilla.

Pak ditë më vonë, më 24 korrik, një avion Sukhoi që do të shkelte kufirin izraelit me disa kilometra është rrëzuar nga një bateri raketash Patriot izraelite, mbi Lartësitë Golan. Avionit rus, por në përdorim të trupave të al Assad, ishte impenjuar në përplasjet me forcat rebele akoma të pranishme në zonë, ka mundësi milicë të ISIS-t të pranishëm në zonën Yarmouk. Këto dy episode demonstronë sesi përtej vullnetit rus për të shërbyer si arbitër, nervozizmi izraelit në zonë rrezikon që të prodhojë incidente serioze, edhe pse në muajt e fundit kanë qenë të shumta inkursionet e avionëve me Yllin e Davidit në territorin sirian për të goditur bazat iraniane.

LUFTË ME INTENSITET TË ULËT DHE NDËRMJETËSIM RUS. PËR MOMENTIN...

Duke dashur që ta përmbylim, është e mundur të pohohet se Irani dhe Izraeli kanë zgjedhur Sirinë si terren përplasjeje në të cilin të testojnë dinamikat respektive të forcës. Problem është nëse të dy konkurrentët dhe elitat respektive politike do të dinë të ruajnë gjakftohtësinë, duke shmangur që konflikti të marrë një formë më të drejtpërdrejtë. Eskalimet e mëtejshme ka mundësi që mund të jenë dy:

- Një aksion i avionëve izraelitë në territorin Iranian për të goditur instalimet atomike. I pamundur, të paktën në këtë fazë;

- Një aksion penetrimi izraelit në territorin sirian në anën e Lartësive Golan të kontrolluara nga damasku.

Sigurisht që duket e qartë të përcaktohet nëse aksioni i dytë është më i mundur. Megjithatë është sigurisht në linjë me doktrinën strategjike të shtetit hebraik.

Përtej përplasjeve dhe provokimeve, Izraeli është në fakt i impenjuar prej muajsh në një aksion tipik frenimi të penetrimin iranian në Siri dhe ka mundësi që kërkon tek Rusia spondin që një gjë e tillë të ketë sukses. Pavarësisht kësaj, ka mundësi që është duke përgatitur operacione në shkallë më të gjerë. Në fakt, disa burime sinjalizojnë një forcim të 210/a Divizionit Bashan në ruajtje të Lartësive Golan. E kotë të kujtohet sesi doktrina izraelite parashikon aksione roll back. Operacioni "Paqe në Galilea" i vitit 1982, pushtimi i jugut të Libanit i vitit 2006 dhe pushtimi i Gazas në vitin 2009 i janë shembujt.

Një gjë është rivendosja e një statuskuoje që shikon sërish Divizionin Bashan të ndeshet me trupa të rregullta të Damaskut me OKB-në në mes, një gjë tjetër është të pranosh që forcat Padsaran dhe Hizballahu të istalohen në Lartësitë Golan siriane dhe nga aty të organizojnë operacione penetrimi në Galilean e Sipërme. Nga ana tjetër, drejtuesit ushtarakë të Republikës Islamike nuk e fshehin vullnetin për ta vendosur më tej zonën e tyre të influencës mbi të gjithë Levantin arab. (*Geopoliticus*)

Kosova në këtë fjalor paraqitet si entitet i mëvetësishëm dhe i tërësishëm politik, historik, ekonomik, arsimor dhe kulturor, duke u bërë kështu një kundërvënie e fuqishme ndaj tendencave dezitegruese, të cilat kanë filluar të shfaqen së fundi dhe që kanë krijuar hapësirë më të madhe se kurrë

Nga Mehmet KRAJA

Të gjithë në njëfarë mënyre kemi qenë skeptikë se do të realizohet ky projekt. Nuk kemi dyshuar në përkushtimin tonë, por kemi qenë të vetëdijshëm për vështirësitë, me të cilat do të ballafaqohemi. Ka qenë një maratonë, në të cilën, natyrisht, jo të gjithë kanë pasur të njëjtën kurajë dhe qëndrueshmëri. Megjithatë, pavarësisht nga abstenimet e ndonjë rasti, pesë vjet me radhë kemi bashkëpunuar si kurrë më parë dhe për këtë u jam mirënjohës të gjithëve, në rend të parë anëtarëve të Redaksisë Qendrore, të cilët më kanë mbështetur në çdo rast, pastaj të 24 redaktorëve të fushave, anëtarëve të redaksive të fushave dhe, natyrisht, të gjithë 506 autorëve të teksteve.

Puna rreth Fjalorit ka kaluar nëpër faza të ndryshme, duke filluar nga identifikimi i fushave, i lëndës që duhej përfshirë, pastaj i përzgjedhjes dhe klasifikimit të kësaj lënde, vjelja e të dhënave dhe natyrisht përpjekja që për herë të parë të krijojmë një standard i prezanti-

SI U REALIZUA FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS



mit, respektivisht i shkrimit enciklopedik. Të gjithëve na ka munguar përvoja dhe këtë punë e kemi bërë duke mësuar së bashku.

Krahas përdorimit të gjerë që mund të ketë Fjalori, identifikimi i lëndës enciklopedike dhe krijimi i një baze të të dhënave duhet të jetë arritja më e rëndësishme e këtij botimi. Pas botimit, natyrisht, vjen faza e shqyrtimit publik, e vërejtjeve dhe kritikave, të cilat duhet të merren para sysh, në mënyrë që një botim i ardhshëm të jetë më i plotë dhe më me pak gabime. Në përfshirjen e lëndës enciklopedike dhe në prezantimin e saj, përveç kriterit të gjithëpërfshirës, është ndjekur edhe parimi i qasjes pozitive ndaj subjekteve të zërave enciklopedikë. Dhe, mbi të gjitha neutraliteti politik, i cili ka qenë domosdoshëm në këtë rast. Sikundër mund ta vëreni, Kosova në këtë

fjalor paraqitet si entitet i mëvetësishëm dhe i tërësishëm politik, historik, ekonomik, arsimor dhe kulturor, duke u bërë kështu një kundërvënie e fuqishme ndaj tendencave dezitegruese, të cilat kanë filluar të shfaqen së fundi dhe që kanë krijuar hapësirë më të madhe se kurrë.

Botimi i këtij Fjalori ka dëshmuar se ne kemi potencial solid për projekte të kësaj natyre, që nuk e kishim më herët dhe nuk e kishim me një përqendrim të këtyllë. Studiues, profesorë universiteti, shkrimtarë, publicistë dhe njerëz të dijes, të mbledhur kështu së bashku, ndërsa kanë shkruar për gjeografinë e Kosovës, për historinë, për arsimin, artin dhe letërsinë, për informimin, për fusha të ndryshme të shkencës, pra, të mbledhur së bashku përbëjnë një zë të fuqishëm për Kosovën integrale, të qëndrueshme kundrejt ideve arriviste.

Tetori shqiptar i Sandra Hoffmann

"Paula" është një vepër e mirëpritur nga kritika letrare e cila, mes të tjerash, ka shkruar: "Është një tekst i pasur! I pasur me figura, tragjikë dhe guxim, i pasur me gjetje dhe me trillime, i pasur me tmerre dhe ngushëllime, zgjuarsis dhe ndjenjë" (Alissa Walser)

Sandra Hoffmann shkrimtarë e njohur gjermane do të jetë përgjatë një muaji në Tiranë. Është hera e tretë që shkrimtarë të njohur nga Gjermania bëhen pjesë e veprimtarive kulturore të "Tetorit gjerman". Pas Karen Köhler dhe Dorian Steinhoff, këtë vit, Goethe-Zentrum Tirana, Ambasada Gjermane dhe Shoqata Poeteka sjellin në Tiranë shkrimtaren Sandra Hoffmann.

Gjatë muajit tetor, Sandra Hoffmann do të jetë pjesë e programit rezidencial për shkrimtarët, për të realizuar një kalendar të larmishëm kulturor, si pjesë e veprimtarive të "Tetorit Gjerman", i cili këtë vit zhvillohet nën moton "Frymëzuar nga njerëzit". Sandra Hoffmann është një autoretore mjaft e vlerësuar nga kritikët në Gjermani, fituese e disa çmimeve të përmendura letrare e më së fundi edhe e

Hans-Fallada-Preis 2018, për romanin "Paula" i cili, përkthyer në gjuhën shqipe nga Sokol Mici do të shtohet gjerdanit të botimeve nga letërsia bashkëkohore europiane të "Botimeve "POETIKA". Gjatë qëndrimit të saj në Tiranë, Sandra Hoffmann do të ketë mundësinë të krijojë lidhje me skenën kulturore shqiptare, të njohë më thellë qytetin, vendin dhe njerëzit e tij dhe t'i kushtohet shkrimeve të saj. Përmes veprimtarive të posaçme në Shkodër (Qendra Rinore Arka) dhe Tiranë (Hemingway Bar dhe Libraria Tirana Times), ajo do i ofrojë publikut shqiptar kënaqësinë e rrallë të pjesëmarrjes në leximet autoriale, në seminare me studentë të gjermanishtes, ku Sandra Hoffmann do të bashkëbisedojë me pjesëmarrësit, do të ndajë përvojën krijuese si dhe do të lexojë pjesë nga romani i saj



"Paula". Ky roman i shkruar me guxim dhe butësi, që i kushtohet "...një familjeje, tri grave, tri brezave—dhe një heshtjeje të thellë mes tyre, kundrejt të cilës të ndihmon vetëm një gjë: të rrefesh". Sandra Hoffmann (1967) studioi për Letërsi, Studime Mesjetare dhe Studime Italiane në Universitetin e Tübingen-it, ku mbrojti edhe Masterin. Prej vitit 1998 deri në vitin 2002 ajo ka qenë asistente e hulumtimit shkencor pranë Katedrës për Letërsi Krahasuese në Tübingen. Në vitin 2004 ajo mori pjesë në konkursin letrar Ingeborg Bachmann në Klagenfurt. Prej vitit 2010 është pedagoge në Qendrën për Studime të Aplikuara Kulturore dhe Studime të Përgjithshme pranë Institutit të Teknologjisë në Karlsruhe. Që prej vitit 2003 është shkrimtare në profesion të lirë. Sandra Hoffmann jeton në Mynih.

EKIPI NGA ÇAIR MBETET PA TRAJNERIN HAJATI SOJDASH

ARDIAN NUHIU MERR TIMONIN E SHKUPIT?

Pas largimit të Hajati Sojdash, bankina e FC Shkupi mund ti besohet përsëri Ardian Nuhiut. Është kjo dëshira e drejtuesve të klubit nga Çairi, të cilët dëshirojnë ta rikthejnë Nuhiun përsëri në rolin e trajnerit të parë

Shkup, 2 shtator - FC Shkupi ka mbetur pa trajner, pasi strategu turk Hajati Sojdash është larguar nga Çairi. Sojdash nuk është paraqitur në stërvitjen e djeshme të skuadrës "bardheblu", ndërsa e njëjta është udhëhequr nga ndihmësit e tij. Arsytet e largimit të strategut turk si duket janë rezultatet e dobëta të zhvilluara në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë, me Shkupin që renditet e fundit në tabelë me vetëm 5 pikë të tubuara. Sojdash udhëhoqi klubin në 5 ndeshje kampionale, në të cilat regjistroi vetëm një fitore si vendas ndaj Makedonija G.P, ndërsa pësoi në 4 ndeshjet e tjera përballë kundërshtarëve si Shkendija (1:2), Vardari (1:2), Bellasica (0:1) dhe Renova (0:2). Pikërisht disfata e fundit i dha fund durimit të drejtuesve të FC Shkupit. Kujtojmë



që Sojdash në Çair erdhi si zëvendësues i Zekirija Ramadanit, që dha dorëheqje pas eliminimit të Shkupit nga Kupa e Maqedonisë në xhiron e parë. Në këtë situatë, drejtuesit e Shkupit janë në kërkim të një trajneri të ri, ndërsa ditëve në vijim pritet edhe vet klubi të bëjë njoftimin zyrtar për ndryshimet në

postet e bankinës. Pas largimit të Hajati Sojdash, bankina e FC Shkupi mund ti besohet përsëri Ardian Nuhiut. Është kjo dëshira e drejtuesve të klubit nga Çairi, të cilët dëshirojnë ta rikthejnë Nuhiun përsëri në rolin e trajnerit të parë. Sipas burimeve të gazetës Koha, bisedimet kanë filluar mes dy klu-

beve FC Shkupi dhe FC Drita nga Gjilani, aty ku Nuhiu aktualisht po ushtron detyrën e ndihmëstrajnerit bashkë me trajnerin e parë Shpëtim Duro. Jo zyrtarisht, gjatë javës pritet të merret vesh se a do të rikthehet në Çair, Nuhiu, ose drejtuesit e klubit bardheblu do të kërkojnë ndonjë trajner tjetër.

Sërish dy skuadra nga Kosova në garat evropiane

Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se ka marrë zyrtarisht njoftim nga UEFA se edhe në edicionin e ardhshëm të garave evropiane do të marrin pjesë dy klube kosovare. Kampioni do të garojë në rrethin parakualifikues të Ligës së Kampionëve, kurse fituesi i Kupës në rrethin parakualifikues të Ligës së Evropës. FFK ka thënë se pavarësisht rezultateve pozitive së fundmi, shtimi për edhe një klub mund të vijë vetëm në vitet e ardhshme. "Cikli i prezantimit të klubeve në garat e UEFA-s ndryshon çdo tri vite, prandaj përkundër rezultateve pozitive të klubeve të Kosovës në kampanjën e fundit të ndeshjeve në garat e UEFA-s dhe kërkesës së FFK-së për shtimin e të paktën një klubi në garat ndërkombëtare, ai ndryshim nuk ka reflektuar menjëherë, por efektet mund të ndodhin në vitet në vijim. Të shpresojmë se një gjë e tillë do të ndodhë por kjo varet shumë nga paraqitja e skuadrave të Kosovës në këto dy gara prestigjioze", shkruan FFK-ja në njoftim.

Berisha rikthehet në Përfaqësuesen e Kosovës

Valon Berisha do të rikthehet pas një viti të Përfaqësuesja e Kosovës në futboll. Sport News mëson që 25-vjeçari do të grumbullohet për dy ndeshjet e ardhshme kundër Maltës dhe Ishujve Faroe. Mesfushori i Lazios për herë të fundit ka veshur fanelën e Dardanëve më 13 nëntor 2017, kundër Letonisë, miqësore të cilën Kosova e kishte fituar 4-3 në Mitrovicë. Prej se është emëruar trajneri i ri Bernard Challandes, Berisha nuk është grumbulluar asnjëherë me Ko-



sovën dhe gjithnjë arsyetim ka qenë lëndimi, edhe sa ishte pje-

së e Salzburgut, por edhe pasi kaloi në Itali, mungoi në dy nde-

shjet e shtatorit në Uefa Nations League. Sido që të jetë tani futbollisti më i shtrenjtë i Kosovës është rikuperuar plotësisht nga lëndimi dhe po pret të debutojë me Lazion. Trajneri Simone Inzaghi e ka grumbulluar për dy ndeshjet e fundit me Udinesen dhe Romën, por në asnjërin duel nuk e inkuadroi në lojë. Mbetet të shihet a do të debutojë këtë të enjte në Ligën e Europës me bardhekaltrit, që janë mysafirë të ekipit gjerman Eintracht Frankfurt.

Ramadani me ftesë nga kombëtarja shqiptare U21, Broja te Kosova

Shkup, 2 shtator - Skuadra e FC Shkupit këtë sezon përkundër një fillimi të vështirë në kampionat, ka arritur që të nxjerr nga shkolla e futbollit talentet e saja që edhe po jep frytin e dëshiruar. Pas Suhejl Muharemit që tani më është pjesë e të gjitha ndeshjeve me reprezentacionin e Maqedonisë në kategoritë e reja, sot në adresën elektronike të klubit edhe zyrtarisht ka marrë ftesë Besir Ramadani, i cili do të veshë fanelën e kombëtares

shqiptare U21. Paraqitjet e mira me ekipin e Shkupit në ndeshjet e fundit, kanë bindur seleksionuesin e kombëtares kuq e zi Alban Bushi, që ta ftojë Ramadanin për dy ndeshjet e radhës, Shqipëri - Spanjë që luhet me 11.10.2018 dhe Estoni - Shqipëri që do të luhet me 16.10.2018. Kjo është edhe një dëshmi se ekipi po mundohet që të formojë një bazë të shëndoshë në skuadër, që vitet që pasojnë të kemi ekip edhe më stabile, që do të

përbëhet nga futbollist tanë. Të përkujtojmë se deri më tani me ekipin e seniorëve kanë debutuar edhe Musli Lika dhe Jusuf Aliu. Gjithashtu ftesë për të luajtur me reprezentacionin e Kosovës ka marrë edhe mesfushori Rron Broja, i cili me Kosovën do të luajë ndaj Izraelit me grupmoshat U21. Rron Broja shkaku i lëndimit kishite munguar në dy ndeshje, por rikthimi i tij ishte në ndeshjen ndaj Renovës.



ALISSON TREGON PËRSE KA DERDHUR LOT DHE ZBULON BISEDËN E PARË ME KLOPP

“Kur të dy klubet arritën marrëveshjen, Klopp më telefonoi në “Face Time” dhe më shpjegoi projektin e tij dhe atë që donte nga unë. E admiroj që nga koha kur ishte te Dortmund. Është një njeri inteligjent dhe me karakter. Nuk flet shumë, por di gjithmonë çfarë të thotë. Është futur në dhomat e zveshjes, pas gabimit tim kundër Leicester, edhe nisi të qeshte, kur unë isha gati të qaja”, ka deklaruar Alisson



bëra një zgjedhje profesionale, një hap përpara në karrierën time dhe Roma fitoi shumë para. Me tru vendosa të shkoj te Liverpool, por zemra ime ishte për të qëndruar te Roma, ku kalova dy vite të shkëlqyera, ku lindi vajza ime dhe kisha shumë miq, edhe jashtë futbollit. Shpesh herë kam bërë shëtitje

darkën vonë në këtë qytet, një bukuri e rrallë. Vendi im i preferuar ishte Koloseu, atje përjetoje historinë. E pranoj që kam qarë kur ika”, në këtë mënyrë ka folur Alisson Becker, që sot mbush 26 vjeç dhe nesër do të kthehet në Itali për të luajtur kundër Napoli, këtë herë duke mbrojtur portën e Liverpool.

Një nga portierët më të mirë të planetit, i dyti më i paguar në histori, 73 milionë euro, Alisson tregon: “Premier League është ndryshe nga Italia, atje ka më shumë ritëm. Por unë në Itali mësova shumë prej Marco Savorani, një njeri thelbësor në rritje time dhe të Szczyzny. Një nga njerëzit më të rëndësishëm të jetës time, që më ka ndihmuar edhe jashtë fushë”. Në fund, Alisson tregon bisedën e parë me Klopp: “Kur të dy klubet arritën marrëveshjen, Klopp më telefonoi në “Face Time” dhe më shpjegoi projektin e tij dhe atë që donte nga unë. E admiroj që nga koha kur ishte te Dortmund. Është një njeri inteligjent dhe me karakter. Nuk flet shumë, por di gjithmonë çfarë të thotë. Është futur në dhomat e zveshjes, pas gabimit tim kundër Leicester, edhe nisi të qeshte, kur unë isha gati të qaja. E kuptova se kisha bërë një marrëzi, por ai më tha, vazhdo të luash në të tillë mënyrë, përndryshe mërzitem edhe unë. Më dhanë kurajë fjalët e tij”, ka theksuar Alisson.

Mbappe te City

Kylian Mbappe nuk transferohet te Manchester City. Pep Guardiola po mendon që të bëjë edhe disa transferime në janar. Trajneri i Manchester Cityt dëshiron që ta forcojë edhe më shumë skuadrën, andaj tashmë ka një listë të transferimeve. Mediat në Angli raportojnë se Guardiola e dëshiron Mbappen, mirëpo një gjë e tillë është refuzuar nga vet ai Trajneri spanjoll ka thënë se ata nuk janë të interesuar në transferimin e francezit as në janar, e as në verën e vitit 2019.



Publicitet

Në bazë të nenit 38 dhe 39 të Ligjit për veprimtari-shkencore-hulumtuese Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46/2008; 103/2008; 24/2011, 80/2012; 24/2013; 147/2013 dhe 41/2014), neni 22 të Ligjit për marrëdhënie të punës Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2003; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014 20/2015; 33/2015; 72/2015 dhe 129/2015 dhe Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës së IPSH Institutit për Trashëgiminë Kulturore Shpirtërore të Shqiptarëve - Shkup, shpall:

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhje në titullin shkencor dhe punësimin e një bashkëpunëtori shkencor /docent dhe zgjedhje të një pozite dhe bashkëpunimi si dhe punësimin e një asistenti të ri hulumtues në IPSH Institutin për trashëgiminë kulturore shpirtërore të shqiptarëve - Shkup

1. IPSH Institutit për Trashëgiminë Kulturore Shpirtërore të shqiptarëve-Shkup publikon Konkurs Publik për zgjedhjen në titullin shkencor dhe punësimin e një bashkëpunëtori shkencor /docent dhe zgjedhjen në titullin bashkëpunues si dhe punësimin e një asistenti të ri hulumtues në departamentet e mëposhtme të Institutit:

I. 1 (një) bashkëpunëtor profesional (docent) në Departamentin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike. Kandidatët duhet të kenë përfunduar doktoraturë në shkencat historike ;

II. 1 (një) asistent të ri në Departamentin e Letërsisë Shqipe. Të gjithë kandidatët duhet të kenë të mbaruar fakultetin Filologjik, Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe ;

2. Kandidatët për një bashkëpunëtor shkencor duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të ato të veçanta të përcaktuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës së IPSH Institutit për trashëgiminë kulturore shpirtërore të shqiptarëve - Shkup kategoria A, niveli A3:

-Niveli i kualifikimeve VIII sipas kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara të paktën 480 kredi sipas SETK ose të mbaruar shkallën e VIII;

-Përmeshja e kriterëve për përzgjedhjen në tituj mësimor -shkencor të përcaktuar me Ligjin për veprimtarinë kërkimore shkencore, Ligjin për arsimin e lartë, Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për zgjedhjen në titull më të lartë shkencor (Gazeta Zyrtare e RM numër 82/09).

3. Kandidatët për asistent të ri hulumtues duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IPSH Institutit për trashëgimi shpirtërore dhe kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Kategoria V niveli V2 ;

-Niveli i kualifikimeve VII sipas kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara të paktën 300 kredi sipas SETK ose të mbaruara shkallë VII/2;

-Përmeshja e kriterëve për përzgjedhjen në tituj mësimor-shkencorë të përcaktuar me Ligjin për veprimtarinë kërkimore-shkencore, Ligjin për arsim të lartë, Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për zgjedhje në titull më të lartë shkencorë (Gazeta Zyrtare e RM numër 82/09).

4. Kandidatët e paraqitur në lidhje me konkursin publik duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në origjinal apo në një kopje të vërtetuar në noter:

-Fletëparaqitje

-Biografi e shkurtë dhe bibliografi

-Diplomë për mbarim shkallës shkencore si doktor shkencë , gjegjësisht diplomë për mbarim të fakultetit nga sfera në të cilën janë zgjedhur,

-Listë të punimeve të recensuara shkencore si dhe një kopje nga secili punim,

-Shtetësi, jo më e vjetër se 6 muaj, në origjinal ose kopje të vërtetuar nga noteri.

5. Orari i punës dhe pagesa:

-Orari i punës ditore nga ora 08:30 deri 16:30,

-Orari i punës javore 40 orë pune (nga e hëna deri të premten)

-Paga neto bazë për bashkëpunëtor shkencor është 29.126,00 denarë

-Paga neto bazë për asistent të ri hulumtues është 21.900,00 denarë.

6. Konkursi zgjatë 8(tetë) ditë që nga dita e publikimit

7. Dokumentet dorëzohen në IPSH Institutin për trashëgiminë kulturore shpirtërore të Shqiptarëve -Shkup me postë në adresën e institutit, Shkup , fahu postal 171 ose personalisht (rr. Ilindenska pn, Shkup tek ish Ambasada Amerikane).

8. Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit me dokumentacionin nuk do të merren parasysh.

9. Kandidatët e zgjedhur do të punësohen për një kohë të pacaktuar.

IPSH Institutit për trashëgimi kulturore shpirtërore të Shqiptarëve -Shkup

Në bazë të neneve 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, transkriptin (Gazeta Zyrtare e RM nr. 154/2014), dhe nenin 80 dhe 82 të Ligjit për shkollim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008) dhe Pëlqimi nga MASH nr. 12-10292/21 prej 19.09.2018, Pëlqimi nga komuna e Çairit nr. 09-1884/2 prej 26.09.2018 SHF “Hasan Prishtina” Shkup , Çair, publikon

SHPALLJE

Për të plotësuar vendet e punës në vijim deri më 31.08.2019

Për mësimin në gjuhën shqipe

1. një mësues për mësim klasor me 20 orë mësimore (40 pune) dhe paga neto 21.660,00 denarë

2. një mësues në lëndën e gjeografisë me 10 orë mësimore dhe paga neto 10.830,00

Për mësimin në gjuhën maqedone

1. një mësues për mësim klasor me 20 orë mësimore dhe paga neto prej 21.660,00

Orari i punës së mësuesve është në dy ndërrime nga ora 07:30 ndërrimi i parë dhe prej në 13:30 ndërrimi i dytë ,dhe përfundon sipas orarit të orëve për vitin shkollor 2018/19.

Punëtorët kanë të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në përputhje me LMP.

Kandidatët nën (pikat 1 deri 3) përveç kushteve të përgjithshme të parapara nga LMP, duhet të plotësojnë kushtet sipas neneve 80 dhe 82 të Ligjit për Arsimin fillor (Gazeta Zyrtare 103/08).

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

-biografi të shkurtë

-dokument për arsimin të mbaruar të përshtatshëm (origjinal ose kopje të notuarizuar në noter)

-vërtetim të shtetësisë

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të shpalljes. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas përfundimit të shpalljes.

Dokumentet jo të plota dhe jo në kohë të paraqitura nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në SHF “Hasan Prishtina” Çair, Shkup, rr. Kosta Abrasheviq nr. 7 Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05,106/08...167/2015), dhe neni 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10,...30/2016), Drejtori i SHFK “Dame Gruiev” - Gradsko publikon:

SHPALLJE

Për plotësim të vendit të zbrazët të punës për kohë të caktuar të punës deri në fund të vitit shkollor 2018/2019

1. Mësimdhënës të shkencave natyrore matematikës me 2 orë mësimore të fondit javor, pagesa fillestare prej

2.166,00 denarë...1 realizues

2. Psikolog me 40 orë pune të fondit javor, pagesa fillestare 21.661,00 denarë...1 realizues

Orari ditore i punës për të punësuarit me orar të plotë të punës është 8 (tetë) orë edhe atë të kuadrin mësimor prej ora 07.30 deri në ora 15.30, të punëtorëve profesional prej ora 08.00 deri në ora 16.00. Orari i punës me orar të plotë të punës është 40 orë të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune, ndërsa për kuadrin mësimor me orar jo të plotë të punës është varësisht nga numri i orëve mësimore.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP duhet të përmeshin edhe kushtet e posaçme të parapara me nenin 42 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor.

Së bashku me fletëparaqitjen për punësim parashtrihen dokumentet në vijim edhe atë:

-Certifikatë të shtetësisë

-Diplomë për arsim të mbaruar në pajtim me normativin e kuadrin mësimor.

Në fletëparaqitjen për punësim obligohet që të shënohet e-mail adresa në mënyrë që të caktohet testimi për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditore.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 (peshëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit për parashtrim të dokumenteve, gjegjësisht realizimit të testimit.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën SHFK “Dame Gruiev” - Gradsko, rr. Marshall Tito nr. 68 - Gradsko

SHFK “Dame Gruiev” - Gradsko

Drejtor

Lençe Stojanova

LIGA E KAMPIONËVE

POCHETTINO: BARCELONA SHKON PËRTEJ TRAJNERIT, FALË MË TË MIRIT NË BOTË

Barcelona është një skuadër me lojtarë të mëdhenj, përcaktues dhe që mund të fitojnë me gjithkënd. Përveç Messit, dua të veçoj edhe Coutinho, Dembélé, LuisSuárez... Janë futbollistë të shkëlqyer. Coutinhon e njoh shumë mirë. Ne po flasim për një ekip të shkëlqyeshëm, të udhëhequr nga më të mirët në botë, siç është LeoMessi



Mauricio Pochettino do të përballë në Champions me Barcelonën dhe Leo Messin. Natyrisht, një moment i veçantë ky për vetë trajnerin argjentinas dhe "Spurs". Ai mundohet të analizojë kundërshtarin katalanas, duke njohur filozofinë e veçantë të lojës së tyre. Në një intervistë për "Marca", ndër të tjera ka nënvizuar: "Është e qartë se tani, në këtë fazë të fundit, Barcelona nuk ka më Xavi apo Iniesta. Kanë mbetur pak futbollistë të atij brezi dhe është normale që Barcelona ta ketë ndryshuar futbollin e saj. Valverde është përpjekur të ndryshojë, por duke ruajtur parimet, duke i dhënë nuanca lojës së Barcelonës, e cila është pasuruar. Futbolli është për futbollistët dhe, kur keni lojtarë aq të mëdhenj sa Barcelona, të aftë për të shënjuar filozofinë përtej trajnerit, është e vështirë t'i ndryshoni ato. Për të zëvendësuar këtë lloj futbollistësh është e pamundur. Ata kanë qenë unikë, me talent të madh. Ju mund të afroni lojtarë të tjerë, por ata janë të ndryshëm. Dhe kur vjen puna për të treguar futbollin që dëshironi t'u mësoni, gjithmonë do të jetë shumë e vështirë. Barcelona është një skuadër me lojtarë të mëdhenj, përcaktues dhe që mund të fitojnë me gjithkënd. Përveç Messit, dua të veçoj edhe Cou-

tinho, Dembélé, LuisSuárez... Janë futbollistë të shkëlqyer. Coutinhon e njoh shumë mirë. Ne po flasim për një ekip të shkëlqyeshëm, të udhëhequr nga më të mirët në botë, siç është LeoMessi. Cilësia spikat kudo, në çdo repart të Barcelonës. A duam ta mposhtim Barcelonën? Natyrisht, po. Fitimi i një loje është gjithmonë diçka e mirë në futboll. Kur fiton ndaj Barcelonës, vlen edhe më shumë, sepse kjo do të thotë diçka e rëndësishme për ne", ka thënë Pochettino. Argjentinas ka drejtuar Espanyol në La Liga, pasi më parë ka qenë futbollist i bardhebluve. Ai mendon se është e pamundur që të jetë trajner i Barcelonës në të ardhmen dhe pohon se Leo Messi është futbollisti më i mirë në planet. "Sfida me Barcelonën më motivon shumë sepse kam jetuar shumë vite në këtë qytet si futbollist, trajner dhe tifoz i Espanyol", tha argjentinas. Rrugë ime me atë të Barcelonës janë në drejtime diametralisht të kundërta dhe mendoj se është e pamundur, me të vërtetë e pamundur, që unë të marr drejtimin e kësaj skuadre". Tottenham vjen pak i tronditur në sfidën kundër Barcelonës, pas goditjes që mori në ditën e parë të Ligës së Kampionëve. Ishte vërtet e dhimbshme, sepse ndeshja ndaj In-

terit u kontrollua prej nesh. Ishim më afër golit tonë të dytë, sesa barazimit. Fatkeqësisht, e përfunduam lojën me humbje. Duhet të nxjerrim mësim nga këto lloj humbjes, t'i analizojmë me hollësi ato. Duhet të na shërbejnë për t'u përmirësuar. Kundër Barcelonës ekziston një motivim i madh. Ne do të bëjmë gjithë luftën e mundshme. Për mua, Messi është ende numri një në botë dhe do të jetë i tillë derisa të luajë futboll". Nga ana tjetër lajme të këqija për Elseid Hysajn. Mbrojtësi i Kombëtares kuqezi me shumë gjasa do të jetë në stol në takimin e kësaj mesjave në Champions. Paraqitjet e fundit që shkodranit nuk kanë qenë të mira, madje në takimin me Juventusin u kritikua jo pak. Siç raportojnë mediat italiane Hysaj me shumë gjasa do ta nisë nga stoli ndeshjen ndaj Liverpoolit. Vendin e tij në të djathtë të mbrojtjes pritet që ta zërë Kevin Malkuit, i cili la Lilën në verë për të shkuar në Itali. Francezi ishte titullar ndaj pames, por u aktivizua dhe ndaj Juves në pjesën e dytë. Hysaj është konsideruar i paprekshëm, por fakti që 27-vjeçari po luan në arenën ndërkombëtare mund ta vërë në pikëpyetje paprekshmërinë e lojtarit kuqezi. Një paraqitje e mirë e Malkuit ndaj "The reds" me

shumë mundësi do ta ndryshonte hierarkinë në krahun e djathtë të mbrojtjes napolitane dhe ky është një lajm i keq për Hysajn. Portieri i Liverpoolit, Alisson ka paralajmëruar ekipin e tij se do të ketë një punë të vështirë ndaj Napolit në Ligën e Kampionëve të mërkurën. Skuadra e Jurgen Kloppit do të udhëtojë drejt "San Paolos" për të kërkuar fitoren e dytë në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve. "Është gjithmonë e vështirë të luaj ndaj një klubi të madh. Në Napoli, ne padyshim që do të gjejmë tifoz shumë të pasionuar dhe një skuadër që hyn në fushë me një dëshirë të madhe për të fituar", deklaroi Alisson. "Hera e fundit dhe e vetme që unë luajta atë, ne fatmirësisht fituam, por ishte njëra prej ndeshjeve që duhej të punoja më së shumti gjatë edicionit. Ishte njëra prej ndeshjeve më të vështira të edicionit për neve në Serie A, kështu që do të jetë një ndeshje e vështirë. Ata e kanë pasur bazën e njëjtë të skuadrës për tre apo katër vite", shtoi ish-portieri i Romës. "Shpresoj që ne të kemi një ndeshje të madhe dhe të arrijmë fitore, por padyshim që do të jetë një sfidë e madhe për ne", u shpreh ai. Në kuadër të ndeshjeve në grupe në Ligën e Kampionëve ka folur edhe

trajneri i Francës Didier Deschamps. Dominimi në Ligue 1 nuk do ta ndihmojë PSG-në të triumfojë edhe në Champions League. PSG ka fituar pesë nga gjashtë kampionatet e fundit në Francë dhe kanë fituar tetë ndeshjet e para të kampionatit aktual. Pavarësisht nga kjo, ky dominim në Ligue 1 nuk është përkthyer akoma në një sukses evropian. Thomas Tuchel ka marrë vendin e Unai Emery këtë verë dhe detyra e tij është t'i japë fund eliminimeve të parakohshme në Champions League. Por, Deschamps, i cili e vlerëson gjermanin, nuk beson se ai do ta udhëheqë PSG-në drejt tokës së premtuar. "Ai është shumë i aftë, i kujdesshëm ndaj çdo detaji, ka autoritet dhe krijon lidhje të forta me lojtarët", ka thënë trajneri francez për "Bild". "Por nuk është një magjistër. Parisi luan në një kampionat ku fitojnë me lehtësi dhe më pas e shikojnë veten në Champions League, përballë një kundërshtari me cilësi të mëdha, që sulmon vazhdimisht". Liverpool e nisi këtë edicion të Championsit me një humbje 3-2 të pësuar në fushën e Liverpool dhe të mërkurën do të luajnë kundër Crvena Zvezda. Francezët do të shikojnë në atë takim pas një fitoreje 3-0 të marrë në javën e fundit të kampionatit kundër Nice.

TAKIMET

GRUPI A

ATLETICO M - CLUB BRUGGE

21:00

B. DORTMUND - MONACO

21:00

GRUPI B

PSV - INTER

21:00

TOTTENHAM - BARCELONA

21:00

GRUPI C

PSG - CRVENA ZVEZDA

18:55

NAPOLI - LIVERPOOL

21:00

GRUPI D

LOKOMOTIV M. - SCHALKE 04

18:55

PORTO - GALATASARAY


21:00

Nga Bayerni në kategorinë e nëntë në Angli!

Ish-sulmuesi i Bayern Munich, Dale Jennings, do të ketë mundësinë të vazhdojë të luajë futboll, teksa është bashkuar me Runcorn Town, në North West Counties League, kategoria e nëntë angleze. Jennings ishte vetëm 18 vjeç kur Bayern e bleu nga Tranmere Rovers. Ai luajti 36 ndeshje për ekipin

"B" të bavarezëve, por nuk u aktivizua kurrë me ekipin e parë, ndërsa dy vjet më vonë u kthye në Angli te Barnsley. Aktualisht 25 vjeç, Jennings ka luajtur ndeshjen e fundit si profesionist në vitin 2015 me MK Dons. Jennings e nis edhe një herë nga fillimi karrierën e tij, duke lënë pas shpine disa dëmtime të rënda

dhe dështimin te Bayern. "Isha te një nga klubet më të mëdha të botës, ndërsa tani jam në një nga më të voglat, por vazhdoj të kem të njëjtën kënaqësi kur luaj futboll." Runcorn aktualisht është në vendin e tretë të kategorisë së nëntë, pasi ka fituar shtatë nga tetë ndeshjet e para.





DASHI 21. mars - 20. prill

Një refuzim që do të merrni do ju acarojë së tepërmi. Megjithatë bëhet fjalë për një çështje pune, ndaj bëni mirë të merrni masa. Sa i takon sferës së ndjenjave, mbrëmja parashikohet të jetë mjaft e favorshme.



DEMI 21. prill - 21. maj

Kjo e martë do të jetë mjaft e mbarë dhe relaksuese, e cila do ju lejojë që të vlerësoni me më shumë kujdes, disa propozime që keni marrë së fundmi. Këshillohet të mos nxitoheni në dhënien e një përgjigjeje. Mbrëmja do të jetë mjaft e mbarë për tu kaluar me njerëzit që doni.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Mos u tregoni shumë skeptik në raport me një bashkëpunëtorin tuaj, pasi mund të befasoni nga iniciativat premtuese. Në dashuri, ky është momenti ideal për tu kaluar me partnerin/en.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Mundohuni të tregoni më shumë kujdes për shëndetin, sidomos lidhur nëse i keni vendosur vetes disa objektiva dhe ju duhen më shumë energji. Këshillohet që të mos përfshihen në debate tepër të nxehta.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Mundohuni të mos përqendroheni shumë në debate të kota. Do të jeni kokëfortë dhe impulsiv, ndërkohë që hapet një muaj i rëndësishëm për të ndezur ndjenjat dhe për të bërë një hap të rëndësishëm, në raport me një person që doni.



VIJRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Shmangni tensionet në dashuri ose në familje. Vendosja e një ultimatumit nuk do ju ndihmoni të fitoni një konflikt, ndaj mundohuni të përpunoni strategjitë tuaja. Kjo e martë është mjaft e rëndësishme për të rigjetur qetësinë.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kjo ditë do ju gjejë të luhatur në sjelljen tuaj. Luhatjet e humorit, mund të shkaktohen nga një situatë jo shumë e këndshme në vendin e punës. Këshillohet që në dashuri dhe familje, të mos jeni shumë agresiv.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mundohuni të mos rrezikoni shumë në investime, për të cilat nuk jeni të sigurtë. Në këtë moment është e rëndësishme që të gjeni përqendrimin dhe të çoni deri në fund të gjitha projektet tuaja. Kjo ditë ju fton që të tregoni kujdes në dashuri.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ky është momenti më i mirë për të kaluar bashkë me familjen dhe me personat që doni. Ka disa keqkuptime të cilat duhet ti mbani nën kontroll, por nga ana tjetër keni qenë shumë të lodhur dhe një përgjigje që do të merrni do ju gëzojë. Propozimet tuaja do të vlerësohen maksimalisht.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Do të keni mundësi për të bërë disa ndryshime të frytshme lidhur me projektet tuaja. Nga pikëpamja sentimentale, ka disa dyshime të cilat duhet ti zgjidhni para se të hyni në konflikt me partnerin/en, shkruan noa.al. Duhet të jeni të qartë me veten tuaj dhe të bëni një ballafaqim, pa u treguar shumë agresiv.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë do të jetë mjaft interesante për të nisur një projekt të ri dhe për të shfaqur më shumë besim në veten tuaj. Edhe në dashuri do të jeni më romantik, ndaj përfiton nga ky moment për të bërë një arratisje të vogël në çift.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Këshillohet që në vendin e punës mos të jeni shumë të ashpër, pasi një sugjerim i një bashkëpunëtori tuaj, mund të jetë mjaft i vlefshëm. Sigurisht ka disa keqkuptime që kërkojnë zgjidhje, por horoskopit i kësaj dite parashikon mundësi të mira në punë. Në dashuri duhet të jeni më të komunikueshëm.

Mensur Mamuti	SPECIALIST NE FUSHEN E GJEODEZISE	ISH FUTBOLLISTI DHE SOT TRAJNERI KOSOVAR NE FOTO	KLUB FUTBOLLISTIK FRANCEZ	PJESAANËSORE E ÇATISE QYTET NE ITALI	A
QYTETI I LINDJES SE FUTBOLLISTIT NE FOTO					
E SHOSHITI					
DHOMA (HUAJ)					
K					
NJËSIA MË E VOGËL SE DENARI					ISH POLITIKAN KINEZ (1888-1979)
KOMPANI USHQIMORE TURKE				SUEDIA QË NUK KANË KUFI	
ZEF MOSI			PËREMËR PRONOR		
KA URL I URITUR			MONEDHË, 1/4 E GRËSHIT (SH. PASHQ.)		
QENI I ÇARLI BRAUNIT					
VEÇORI SHËNJË DALLUESE				PARASHITESË MJEKESORE PER 'HUNDE'	ANA E PJERRËT NE KRAHUN E NJË RRUGE TE NGRITUR
KOHA	NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NE FOTO				LJDHESË NE ADRIATIK
LL. I.			E RRALLË, UNIKE		NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NE FOTO
AUSTRIA		TIMO FLOKO ALUMINI	VESSHJE E SIPËRME E TRASHË	PIKTORI KOSOVAR, BERISHA	
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NE FOTO					MELPOMENI ÇOBANI
SHPREHJE QË ËSHTË PERDORUR SHPESH E QË PËRSËRITET				PRJËSI I VATIKANIT	ART (FRËNGJ.)
OKSIGJENI		AI QË PAGUAN ME KËSTE TAUTOLOGJIA		TEATRI NDERKOMBËTAR	
BANOR I VENDBANIMIT BULLGAR, STOMANTSI					SULFURI



ZGJIDHJET: A, GJILAN, E SITI, KOMORA, DENI, ETI, S, ZM, TU, I URËT, SNUPI, TIPAR, T, SHEKERSPOR, LLI, UNIKALE, A, TF, NAGIP, MARIBOR, MÇ, KLISHE, PAPA, O, KËSTARI, STOMANTSAS.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

		2	4			6	1	8									8	
1		6	3						2	3		5					6	1
			2											1				
				3		5	9	2		2		8					9	
			7		8					8		3	9	6			2	
4	9	1		5					7			4						3
2					1									2				
9					3	7		5	6	7		9					8	5
8					7	2			8									9

Shumë i lehtë: 352479618, 146385927, 789216354, 678134592, 523798146, 491652873, 237561489, 914823765, 865947231. Mesatar: 517629438, 234578961, 968431752, 325187694, 481396527, 796245813, 149852376, 673914285, 852763149.

Kafeja mund të zgjasë jetën e njerëzve me sëmundje të veshkave

"Këshillimi i pacientëve me sëmundje të veshkave për të pirë më shumë kafe mund të zvogëlojë vdekshmërinë e tyre", tha Miguel Bigotte Vieira, një nga autorët kryesorë të studimit dhe një mjek i bazuar në Portugali

Kafeina mund të ndihmojë në përmirësimin e funksionit të enëve të gjakut, tregon një studim i fundit sipas të cili njerëzit me sëmundje të veshkave mund të jetojnë më gjatë nëse pinë më shumë kafe. Pak kafe mund të konsumohet vetëm nëse është sasia që mjeku urdhëron për pacientët me sëmundje kronike të veshkave (CKD). Sipas një studimi në Transplantimin e Dializës në Nefrologji në SHBA, konsumimi i më shumë kafeve ul rrezikun e vdekjes për pacientët me sëmundje të veshkave.

Hulumtuesit besojnë se ndikimet pozitive nga kafeina janë të lidhura me efektet vaskulare, meqë ajo është e njohur për të përmirësuar funksionin e enëve. Ekipi, i udhëhequr nga një mjek nga Portugalia, shqyrtoi të dhënat nga 4863 amerikanë me CKD midis viteve 1999 dhe 2010, si pjesë e Anketës Kombëtare të



Shëndetit dhe Ekzaminimit të Ushqyerjes (NHANES). Edhe pas shqyrtimit të faktorëve të tillë si mosha, dieta dhe sëmundje të tjera, kishte akoma një reduktim në vdekje.

Ata që konsumonin më shumë kafe kishin më shumë gjasa të ishin meshkuj të bardhë me nivele të larta arsimore. Gjithashtu kishin më shumë gjasa të kishin më pak sulme në tru dhe zemër në krahasim me ata që pinin më pak kafe. "Këshillimi i pacientëve me sëmundje të veshkave për të pirë më shumë kafe mund të zvogëlojë vdekshmërinë e tyre", tha Miguel Bigotte

Vieira, një nga autorët kryesorë të studimit dhe një mjek i bazuar në Portugali.

Ai vuri në dukje se ky ishte një studim vëzhgues, kështu që nuk tregon se pirja e kafesë më shumë ul rrezikun e vdekjes në pacientët me sëmundje kronike të veshkave. duhet të konfirmohen me anë të një prove klinike të rastësishme", tha Vieira. Studimi i fundit nuk ishte hera e parë që efektet e kafeinës u studiuan për pacientët me CKD. Një studim i kryer më parë këtë vit në The American Journal of Medicine zbuloi se zhvillimi i sëmundjes ndodhi më pak në njerëzit që pinë kafe çdo ditë.

MOS I HIDHNI MOBILËT E VJETËR:

Katër markat që shiten deri në 1 mijë euro

Telefonat e vjetër mobilë shpesh përfundojnë në bërlllok sapo të blihet një model më i ri, por pas këtij lajmi mendoni dy herë para se të veproni në mënyrë të tillë. Për disa modele klasike, ky mund të jetë një gabim i madh - në eBay ose Amazon, pajisjet e vjetra nga Nokia, Samsung, Motorola shiten deri në 1,000 euro, shkruan Fenix magazin.de.

Këto janë katër pajisje veçanërisht të vlefshme: Nokia 8800 ishte një model i vërtetë luksoz kur u fut në treg në vitin 2005 dhe sot çmimet shkojnë deri në 1000 euro. Edhe Nokia 8810 në eBay varësisht nga shkalla e viteve, ndryshon deri në disa qindra euro.

Në vitin 1998, ai ishte modeli i parë me antenën e vendosur në shtëpizë. Nëse pajisja juaj është ende në gjendje të arsyeshme, mund t'ju sjellë rreth 300 euro. Samsung Matrix SPH-N270 - nuk është saktësisht telefoni më i bukur mobil që



kompania jugkoreane ka prodhuar.

Në eBay, modeli i vitit 2003 vlen qindra euro. Vlera për pajisjen origjinale duhet të jetë shumë më e lartë. Motorola V3 Dolce

& Gabbana - një telefon me palosje në edicionin Dolce & Gabbana është me vlerë 200 euro, pavarësisht moshës dhe kushteve të reja.

Mediat sociale, kanceri i kohës sonë!

Miliarderi Patrick Soon-Shiong mbështeti të mërkurën një ndryshim për mënyrën se si njerëzit konsumojnë lajme mbi mediat sociale, duke i quajtur platformat si "kanceri i kohës sonë". "Intervali i shkurtër i kohës që po krijojmë në këtë mijëvjeçar është në të vërtetë shumë e rrezikshme", tha Soon Shiong, pronari i ri i Los Angeles, La Times.

Ai u shpreh se kjo "Është një nga pasojat e padëshiruara të mediave sociale". Së shpejti Shiong, gjithashtu kryetar dhe CEO i firmës bioteknologjike NantKwest, iu përgjigj një pyetjeje rreth gjendjes që



po përjeton media dhe marrëdhënia e saj në rrjetet sociale. Platformat siç janë Feed-i i Facebook-ut kanë revolucionari-

zuar se si njerëzit konsumojnë mediat dhe si organizatat e lajmeve japin përmajtje. Por ata gjithashtu janë kritikuar për përhapjen e të ashtuquajturve lajme të rreme dhe keqinformim të informacionit. Së shpejti Shiong, një ish kirurg i kthyer sipërmarrës, i tha "Squawk Alley" që nëse them që kjo është kanceri i kohës sonë dhe mediat sociale janë një formë e metastazës së lajmeve. Ai e përshkroi Facebook si një organizatë "reklamuese" dhe prandaj njerëzit nuk mund të dallojnë nga "lajmi i rremë", "lajmi i vërtetë" ose "lajmi i opinionit".

1789 - Xhorxh Uashington shpall për herë të parë për herë të parë Ditën e Falënderimit.

1873 - Kapiteni Xhek dhe bashkëluftëtarët e tij varen për shkak të pjesëmarrjes së tyre në Luftën e Modokut.

1904 - Franca dhe Spanja nënshkruajnë marrëveshje për Pavarësinë e Marokut.

1918 - Borisi shpallet Mbret i Bullgarisë.

1924 - Mbreti Husein i Hixhazit heq dorë nga fronin.

1929 - Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene ndërron emrin në Jugosllavi.

1935 - Italia pushton Etiopinë.

1945 - Paraqitja e parë publike e Elvis Presley në moshën 10 vjeçare.

1968 - Me puç ushtarak largohet nga posti Kryetari Fernando Belaúnde Terry në Peru.

1977 - Arrestohet Indira Gandhi.

1990 - Bashkohen Gjermania Lindore dhe Ajo Perëndimore në një.



BISHTAT E CIGAREVE NË PUSETA!

Duhanpirësit po nxiten për të ndaluar hedhjen e bishtave të cigareve në puseta për shkak të ndikimit të tyre të gjallesat e detit. Sipas Daily Mail, ata janë forma më e përhapur e mbeturinave në Britaninë e Madhe dhe studimet tregojnë se vetëm një bisht cigareje është shumë toksike për peshqit. Shumica e njerëzve nuk kuptojnë se bishtat përmbajnë plastikë dhe mund të shpëtojnë nga sistemet e filtrimit të ujit dhe të ujërave të zeza dhe të përfundojnë në det, thonë ambientalistët. Bishtat, të përbëra nga acetati i celulozës, janë një ndotës i madh i lumenjve dhe deteve në botë. Rreth 3.6 milionë duhanpirës pranojnë se kanë hedhur një bisht cigareje në kanalet e kullimit në Britani muajin e kaluar. Vetëm 38% e tyre kuptojnë faktin që filtrat e cigareve përmbajnë plastikë dhe janë një kërcënim për ambientin.

BARASPESHA

Një i dehur qëndron shtrirë në rrugë. I afrohet një polic.

- Çfarë po bën aty?

- Kam humbur diçka!

- Çka ke humbur ashtu?

- Baraspeshën!



Edhe armiku juaj më i madh, nuk mund t'ju bëjë kurrë aq keq, sa mendimet tuaja të pakontrolluara.

(Buda)